

**NDJEKJA E PUNËS SË
KOMISIONIT SHTETËROR PËR
PENGIMIN E KORRUPSIONIT**



NDJEKJA E PUNËS SË KOMISIONIT SHTETËROR PËR PENGIMIN E KORRUPSIONIT: RAPORT PËR GJENDJEN

Botues: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN)

Për botuesin:

Aleksandar Kërzhhalovski, drejtor i parë ekzekutiv

Gonce Jakovlevska, drejtore ekzekutive

Dizajni: Кома

Kontakti:

QMBN, adresa: rr. "Nikolla Parapunov" nr. 41a; fahu postal 55, 1060 Shkup;

tel. +389/2/3065-381; faks: +389/2/3065-298; posta elektronike: mcms@mcms.mk; ueb-faqja:

www.mcms.mk

Scribd: <http://www.scribd.com/people/documents/2996697>;

SlideShare http://www.slideshare.net/mcms_mk

Facebook: <http://www.facebook.com/mcms.mk>; Twitter: http://twitter.com/mcms_mk

Të gjitha të drejtat janë të mbrojtura. Riprodhimi, kopjimi, shpërndarja apo përkthimi i cilës do pjesë të këtij publikimi mund të bëhet vetëm me kushtet në vijim: me leje paraprake të botuesit, për arsye citimi në analizën e librit dhe nën kushte të parashtruara në vijim.

E drejta autoriale e këtij publikimi është e mbrojtur, por publikimi mund të riprodhohet në cilëndo mënyrë pa kompensim për qëllime edukative. Për kopjimin në kushte të tjera, për shfrytëzimin në publikime apo për përkthim apo adaptim, duhet të sigurohet leje paraprake nga botuesi.

Në formë elektronike, ky publikim është në dispozicion në www.mcms.mk.



**British Embassy
Skopje**

Përgatitja e këtij publikimi është në kuadër të projektit "Ndjekja e punës së Komisionit Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit nga ana e publikut", e përkrahur nga Ambasada Britanike në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet e paraqitura në këtë publikim janë të autorëve.

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	7
2. METODOLOGJIA	9
2.1. INSTRUMENTET E HULUMTIMIT	9
2.1.1. PËRPUNIMI DHE PARAQITJA E REZULTATEVE	10
2.1.2. PËRKUFIZIMET METODOLOGJIKE	12
3. STATUSI, KAPACITETET DHE KOMPETENCAT LIGJORE	13
4. PERFORMANCA	16
4.1. KRIJIMI I POLITIKAVE TË ANTIKORRUPSIONIT	16
4.2. MBYKËQYRJA DHE KONTROLLI	18
4.2.1. MASA DHE AKTIVITETE PËR PENGIMIN E KORRUPSIONIT NË PROCESIN ZGJEDHOR DHE PARTITË POLITIKE	18
4.2.2. MASA DHE AKTIVITETE PËR PENGIMIN E KORRUPSIONIT DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË KRYERJEN E KOMPETENCAVE PUBLIKE TË PERSONAVE TË ZGJEDHUR DHE TË EMËRUAR	20
4.2.3. MASA DHE AKTIVITETE PËR PENGIMIN E KORRUPSIONIT NË SINDIKATA DHE SHOQATA DHE FONDACIONE	25
4.2.4. MASA DHE AKTIVITETE PËR ZBATIMIN E PROCEDURËS PËR MBROJTJE TË LAJMËTARËVE	26
4.2.5. MASA DHE AKTIVITETE PËR PENGIMIN E KORRUPSIONIT NË BAZË TË DENONCIMEVE TË PRANUARA	26
4.3. BASHKËPUNIMI	27
4.4. EDUKIMI	32
4.5. KONKLUZIONE PËR PERFORMANCAT	33

5. TRANSPARENCA	34
5.1. TRANSPARENCA DE JURE	35
5.1.1. KRIJIMI I POLITIKAVE KUNDËR KORRUPSIONIT	35
5.1.2. MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI.....	36
5.1.3. EDUKIMI DHE INFORMIMI.....	39
5.2. TRANSPARENCA DE FAKTO	40
5.2.1. KRIJIMI I POLITIKAVE KUNDËR KORRUPSIONIT	40
5.2.2. MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI.....	41
5.2.3. BASHKËPUNIMI.....	44
5.2.4. EDUKIMI DHE INFORMIMI.....	45
5.3. KONKLUZIONE PËR TRANSPARENCËN	46
6. LLOGARIDHËNIE	47
6.1. LLOGARIDHËNIE PARA INSTITUCIONEVE	47
6.2. LLOGARIDHËNIE PARA PUBLIKUT	49
6.3. KONKLUZIONE PËR LLOGARIDHËNIEN	50
SHTOJCA 1. NUMRI I FLETËVE TË ANKETAVE TË PARAQITURA NË KSHPK	51
SHTOJCA 2. RASTE TË PUBLIKUARA PËR KONFLIKT INTERESASH NË UEB-FAQEN E KSHPK	52
BIBLIOGRAFIA	53

1. HYRJE

Në pajtim me Ligjin për pengimin e korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit (KSHPK) është institucion i mëvetësishëm dhe i pavarur kundër korrupsionit. Mes tjerash, kompetencat e tij janë të lidhura me procesin e krijimit të politikave, vëzhgimit dhe mbikëqyrjes, si dhe bashkëpunimit me organe të tjera shtetërore me qëllim të pengimit të korrupsionit. Edhe pse rezultatet e hulumtimeve të ndryshme të mendimit publik tregojnë se qytetarët e njohin KSHPK si institucionin kryesor shtetëror kundër korrupsionit. Megjithatë, nuk e njohin në tërësi rolin e tij, ndërsa besimi te KSHPK ka shënuar rënie¹. Në vitin 2010, kur u pyetën qytetarët të tregojnë një organizatë qytetare për të cilën konsiderojnë se më së shumti kontribuon në luftën kundër korrupsionit, pjesa më e madhe e qytetarëve e kanë njohur KSHPK si një organizatë të tillë, krahas faktit se KSHPK është institucion shtetëror. Në vitin 2016, më pak se 34% të qytetarëve besojnë se KSHPK mund të ballafaqohet me sukses me korrupsionin, ndërsa më shumë se gjysma apo 58% kanë mosbesim². Rënia e besimit shihet edhe në uljen e numrit të veprimeve ndaj lëndëve për raste konkrete, në të cilat ka dyshime për korrupsion, të iniciuara nëpërmjet denoncimeve të qytetarëve, personave juridik dhe me gjetjet e veta (nga 1.342 në vitin 2010, në 273 në vitin 2015). Njëkohësisht, ka rënë edhe numri i iniciativave të paraqitura për ndjekje penale deri te Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë (nga 14 në vitin 2010, në dy në vitin 2015). Qytetarët, si taksapagues, duhet të jenë të informuar mirë, sepse nëpërmjet buxhetit të Republikës së Maqedonisë i sigurojnë mjetet për realizimin e kompetencave për pengimin e korrupsionit. Transparenca, llogaridhënia dhe efektiviteti duhet të jenë mekanizmat kryesorë për kthimin e besimit te KSHPK, si një nga institucionet kyçe për pengimin dhe uljen e korrupsionit.

1 Nuredinoska E., Sazdevski M., Gjuzelov B (2014). Raport për vlerësimin e korrupsionit në Maqedoni

2 Nuredinoska E., Sazdevski M., Gjuzelov B, Popoviq M. (2016). Raport për vlerësimin e korrupsionit në Maqedoni.

Projekti “Ndjekja e punës së KSHPK” ka për qëllim të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien më të madhe, si dhe forcimin e vetëdijes publike për rezultatet e punës së KSHPK. Nëpërmjet projektit vëzhgohet zbatimi i obligimeve ligjore dhe niveli i transparencës dhe llogaridhënies së KSHPK, si dhe kontributi i tij në luftën kundër korrupsionit në Republikën e Maqedonisë.

Me përjashtim të këtij raporti i cili jep një pasqyrë përmbledhëse të statusit, kapaciteteve dhe kompetencave ligjore të KSHPK për dhjetë vitet e kaluara nga funksionimi, rezultatet nga ndjekja në të ardhmen do të publikohen në raporte tremujore. Qëllimi i këtyre publikimeve është që qytetarët dhe palët e tjera të prekura në mënyrë të rregullt të marrin informata gjithëpërfshirëse për rezultatet e punës së KSHPK. Për vetë KSHPK përfitim nga ndjekja e jashtme paraqet marrja e një note të pavarur për punën e tij. Nëpërmjet konkluzioneve në çdo raport, KSHPK do të ketë mundësi t’i vërtetojë rezultatet e mira të arritura dhe të përmirësohet atje ku është vërejtur mungesa e realizimit.

PROJEKTI “NDJEKJA E PUNËS SË KSHPK”



Projekti “Ndjekja e punës së KSHPK” ka për qëllim të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien më të madhe, si dhe forcimin e vetëdijes publike për rezultatet e punës së KSHPK. Nëpërmjet projektit vëzhgohet zbatimi i obligimeve ligjore dhe niveli i transparencës dhe llogaridhënies së KSHPK, si dhe kontributi i tij në luftën kundër korrupsionit në Republikën e Maqedonisë.

Nëpërmjet raporteve tremujore, qytetarët dhe palët e tjera të prekura në mënyrë të rregullt do të marrin informata gjithëpërfshirëse për rezultatet e punës së KSHPK. Për vetë KSHPK përfitim nga ndjekja e jashtme paraqet marrja e një note të pavarur për punën e tij.

Ky Projekt zbatohet nga shtatori 2016 deri në prill 2018, nga ana e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN), ndërsa përkrahjet nga Ambasada Britanike në Maqedoni.

2. METODOLOGJIA

Metodologjia e cila u zbatua për këtë raport bazohet në përvojat pozitive në ndjekjen e punës së institucioneve kundër korrupsionit nga ana e Qendrës për Studimin e Demokracisë (QSD) nga Bullgaria dhe në bazë të përvojës së QMBN në vëzhgimin e transparencës së institucioneve.

Në këtë raport është përfshirë ndjekja e punës së Komisionit Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit në periudhën prej vitit 2006 deri në vitin 2015. Rezultatet e kësaj periudhe duhet të japin një pasqyrë të efekteve të deritanishme të punës së KSHPK, të cilat do të shërbejnë si vlera rekomanduese për krahasimin e rezultateve nga ndjekja e punës në kohëzgjatjen e projektit.

2.1. INSTRUMENTET E HULUMTIMIT

Metodologjia e cila zbatohet në këto raporte bazohet në formatin e indikatorëve të përgatitur në bashkëpunim me QSD.

Tre gupet e indikatorëve të cilat ndiqen në këtë raport janë:

1. Indikatorë të performancave (IP) – japin përgjigje se a i plotëson dhe sa i plotëson KSHPK kompetencat të cilat i janë dhënë me Ligjin për pengimin e korrupsionit, me Ligjin për pengimin e konfliktit të interesave dhe me Ligjin për mbrojtje të lajmëtarëve;
2. Indikatorë të transparencës (IT) – japin përgjigje për disponueshmëri dhe qasje deri te informatat lidhur me punën e KSHPK për publikun;
3. Indikatorë të llogaridhënies (ILL) – japin përgjigje për nivelin e realizimit të llogaridhënies së ashtuquajtur vertikale para institucioneve para të cilave përgjigjet dhe llogaridhënie horizontale ndaj të gjitha palëve të prekura para të cilave nuk ka përgjegjësi formale (institucione të tjera, sektori qytetar, qytetarët, mediet, bashkësia e biznesit etj.).

Si pikënisje në përcaktimin e indikatorëve të shfrytëzuar me Ligjin për pengimin e korrupsionit, Ligjin për pengimin e konfliktit të interesave dhe Ligjin për lajmëtarët, si tre ligje themelore në bazë të të cilëve vepron KSHPK.

Në procesin e përcaktimit të indikatorëve, nëpërmjet dy punëtorive, u konsultuan edhe ekspertë nga Platforma e Shoqatave Qytetare për Luftë Kundër Korrupsionit. Konsultimet për formatin u bënë edhe me KSHPK, vërejtjet dhe komentet e të cilëve pastaj u përfshinë në versionin e fundit.

Në Shtojcën 1 të raportit është paraqitur edhe formati i indikatorëve.

2.1.1.PËRPUNIMI DHE PARAQITJA E REZULTATEVE

Rezultatet e paraqitura në bazë të përpunimit të informatave të fituara nëpërmjet analizës së të dhënave dytësore të disponueshme në internet, nga të dhënat e fituara nga KSHPK dhe nga pyetësi i ndarë te shoqatat qytetare.

Me qëllim të vlerësimit të bashkëpunimit të deritanishëm të KSHPK me shoqatat qytetare dhe në bazë të Memorandumit të nënshkruar për përkrahje të ndërsjellë të vitit 2010, u realizua anketa me organizatat nënshkruese të Memorandumit. Anketa iu dërgua 18 organizatave qytetare, ndërsa 14 prej tyre u përgjigjën. Anketa u realizua nga 1 deri më 28 shkurt 2017.

Për të gjithë indikatorët për performancat, llogaridhënies dhe efektivitetit, rezultatet bazohen mbi të dhënat e disponueshme për periudhën prej vitit 2006 deri në vitin 2015. Indikatorët për transparencë i përfshijnë edhe të gjitha të dhënat e disponueshme në ueb-faqen, të përpunuara deri më 31 dhjetor 2016.

Për paraqitjen vizuale të realizimit të indikatorëve janë shfrytëzuar tri ngjyra, siç vijon:

**PËRMBUSHJE E PLOTË E INDIKATORIT
(LIGJI ZBATOHET NË TËRËSI)**

**PËRMBUSHJE E PJESËRISHME E INDIKATORIT
(KSHPK VEPRON NË BAZË TË LIGJIT, POR PAMJAFTUESHËM)**

**MOSPËRMBUSHJE E PLOTË E INDIKATORIT (KSHPK NUK VEPRON
SIPAS KOMPETENCAVE TË DEFINUARA ME LIGJ)**

Pasi që “publikimi” i indikatorëve është i lidhur me nivelin e zbatimit të obligimeve të përcaktuara ligjore, indikatorët për të cilët nuk ekziston bazë ligjore janë lënë anash këtij kategorizimi. Shembujt janë de fakto indikatorë për transparencë, sepse ata janë të definuar si një praktikë e dëshiruar, të cilën KSHPK duhet ta zbatojë.

Për vlerësimin e nivelit të rasteve të ngritura për korrupsion dhe konflikt interesash, është përdorur modeli i klasifikimit, të zhvilluar në analizën “A jep rezultate modeli kundër korrupsionit në Maqedoni?”. Modeli i nivelit të korrupsionit përfshin dy parametra: pozitën në sistemin politik apo në administratën publike në të cilën gjendet një person i zgjedhur dhe i emëruar i akuzuar për korrupsion dhe vlerësimi

i shumës së parave të cilat janë keqpërdorur. Për nevojat e kësaj analize modeli është përshtatur (tabela nr. 1) me përcaktimin e tre niveleve të korrupsionit: i lartë, i mesëm dhe i ulët.

TABELA NR. 1 – KLASIFIKIMI I NIVELEVE TË KORRUPSIONIT

	I LARTË	I MESËM	I ULËT
Presidenca	Presidenti i shtetit (të mëparshmit dhe i tanishmi)		
Kuvendi	Kryeministri (të mëparshmit dhe i tanishmi), zëvendësit e kryeministrit dhe ministrave (të mëparshmit dhe të tanishmit, deri në mandatin e partisë së opozitës)	Ish-deputetët	
Qeveria	Zëvendësit e kryeministrit dhe ministrat (të mëparshmit dhe të tanishmit, deri në mandatin e partisë së opozitës)	Ministrat e para një kohe më të gjatë, zëvendës-ministrat dhe sekretarët shtetëror nëpër ministritë	Nivele të tjera të të punësuarve në ministri
Gjyqësori	Gjykatës në Gjyqin Kushtetues dhe atë Suprem (të tanishmit), gjykatësit në Gjyqin e Apelit, Prokurori Publik dhe prokurorët me kompetenca për ndjekje	Ish-gjykatësit në Gjyqin Kushtetues, Suprem dhe të Apelit, gjykatës të tjerë dhe prokurorë	Të punësuar të tjerë në gjyqësor
Partitë politike	Kryetarët e partive politike, të cilat kanë 5 apo më shumë deputetë	Anëtarët e Këshillit Ekzekutiv të partisë në pushtet, të cilët kanë funksione publike; Liderët e partive më të vogla politike	
Vetadministrimi lokal		Kryetarët e komunave dhe anëtarët e Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe të komunave të mëdha	Kryetarët e komunave, anëtarët e këshillit dhe nëpunësit në komunat e vogla dhe të mesme.
Ndërmarrjet publike		Menaxherët, anëtarët e këshillit drejtues të ndërmarrjeve të mëdha publike.	Menaxherët dhe nëpunësit e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme publike.

Sa u përket termeve të përdorura, duhet të theksohet se në këtë tekst përdoret termi “persona të zgjedhur dhe të emëruar”, me të cilin përfshihen personat e zgjedhur dhe të emëruar, persona zyrtar apo persona përgjegjës në ndërmarrjet publike dhe persona të tjerë juridik, të cilët kanë në dispozicion kapital shtetëror dhe të cilët i nënshtrohen Ligjit për pengimin e korrupsionit, Ligjit për konflikt të interesit dhe ligjeve të tjera, në bazë të të cilëve vepron KSHPK.

2.1.2 PËRKUFIZIME METODOLOGJIKE

Me ndjekjen e punës së KSHPK nuk do të përfshihet ndjekja e realizimit të Programit Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit.

Pasi që informacionet u grumbulluan nga raportet vjetore të KSHPK, në një pjesë të raportit për një pjesë të informatave nuk kishim qasje, kështu që në rast se nuk kemi pasur qasje për ndonjë informatë, këto vite nuk janë përfshirë në analizë.

Për një pjesë të indikatorëve nuk mundej të përcaktohet se a bëhet fjalë për mospërbushjen e kompetencës apo për mosekzistimin e bazës për ndërmarrjen e disa veprimeve të caktuara. Shembull për këtë janë indikatorët të cilët kanë të bëjnë me nxitjen e iniciativave para organeve kompetente për kontrollin e punës financiare-materiale të sindikatave apo të shoqatave dhe fondacioneve.



STATUSI, KAPACITETET DHE KOMPETENCAT LIGJORE

PËRBËRJA E TANISHME E KOMISIONIT (I PESTI ME RADHË)

1. Dr. Igor Tanturovski,
kryetar

2. Dr. Farie Aliu, anëtare

3. Goran Milenkov, anëtar

4. Mr. Zhaklina Damçevska
anëtare

5. Najdo Spasevski, anëtar

6. Mr. Suzana Taskova
Axhikotareva, anëtare

7. Sejdi Halili, anëtar

SEKRETARE E PËRGJITHSHME

Dr. Rozeta Trajan


Komisioni Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit (KSHPK) u krijua në vitin 2002, në bazë të Ligjit për pengimin e korrupsionit.

Sipas ligjit, KSHPK është i mëvetësishëm dhe i pavarur në kryerjen e kompetencave të veta, të caktuara me ligj. Komisioni përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët i zgjedhë Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, me mandat prej katër vitesh, me të drejtë edhe të një emërimi. Nga viti 2010, anëtarët janë profesionalisht të angazhuar në kryerjen e funksionit.

KSHPK ka edhe sekretariat i cili i kryen punët profesionale, administrative dhe teknike. Me këtë Sekretariat udhëheq sekretari gjeneral. Sipas sistematizimit të Sekretariatit, janë caktuar në tërësi 51 vend pune për nëpunësit administrativ. Në vitin 2016 janë plotësuar 27 vende pune (53%).

Mjetet për zbatimin e aktiviteteve të veta KSHPK i siguron nga buxheti i Republikës së Maqedonisë. KSHPK për vitin 2017 ka planifikuar buxhet prej 34.664.000 denarë (564.000 euro). Në vitin 2006³ buxheti i KSHPK ka qenë 10.396.417 denarë (rreth 170.000 euro).

³ Nga viti 2006 deri në vitin 2015 të dhënat janë marrë nga Llogaria Përfundimtare e RM, ndërsa për vitin 2016 dhe 2017, të dhënat janë marrë nga Buxheti i RM



GRAFIKON 1. Buxheti i KSHPK nga viti 2006 deri në vitin 2017

Kompetencat themelore të KSHPK janë definuar në Ligjin për pengimin e korrupsionit (neni 49) dhe në Ligjin për pengimin e konfliktit të interesave (neni 21). Sipas kompetencave (tabela 2), KSHPK merr pjesë në krijimin e politikave dhe strategjive kundër korrupsionit, ndërmerr aktivitete dhe masa për pengimin e korrupsionit në zbatimin e pushtetit, kompetencave publike, obligimin zyrtar, politikë dhe shoqata tregtare, pengimin e konfliktit të interesave dhe edukimin dhe informimin. Në mënyrë plotësuese, KSHPK ka kompetenca të cilat kanë të bëjnë edhe me përkrahje në mbrojtjen e personave të cilët bëjnë me dije për korrupsion dhe të cilët janë të përcaktuar me Ligjin për mbrojtjen e lajmëtarëve.

TABELA NR.2 - KOMPETENCAT E KSHPK

KRIJIMI I POLITIKAVE KUNDËR KORRUPSIONIT	<ul style="list-style-type: none"> → Hartim dhe miratim i programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe parandalim dhe ulje të paraqitjes së dukurisë së konfliktit të interesave, si dhe të planit aksional → Sjell program vjetor për punën e vet → Përgatit mendim për projekt-ligje lidhur me parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave
MBIKËQYRJE DHE KONTROLL	<ul style="list-style-type: none"> → Ngrit iniciativa para organeve kompetente për kontroll të punës financiare dhe materiale të partive politike, sindikatave, shoqatave dhe fondacioneve. → Ngrit iniciativa për nisjen e procedurës para organeve kompetente për shkarkim, shpërndarje, zëvendësim apo ndërmarrja e masave të tjera të përgjegjësisë, si dhe procedura për ndjekje penale të funksionarëve të zgjedhur apo emëruar, personave zyrtar apo personave përgjegjës në ndërmarrje publike dhe persona të tjerë juridik të cilët kanë në dispozicion kapital shtetëror.

	<ul style="list-style-type: none"> → Vepron në raste të konfliktit të interesit publik dhe atij personal → Mban regjistër të personave të zgjedhur dhe të emëruar në ndërmarrje publike, institucione publike dhe persona të tjerë publik, të cilët disponojnë me kapital shtetëror dhe e evidentojnë dhe e ndjekin gjenden e tyre pronësore
BASHKËPUNIMI	<ul style="list-style-type: none"> → Bashkëpunon me organe të tjera shtetërore në pengimin e korrupsionit dhe dukurinë e konfliktit të interesave → Bashkëpunon me trupa adekuate kombëtare të shteteve të tjera, si dhe me organizata ndërkombëtare në fushën e pengimit të korrupsionit
EDUKIMI DHE INFO N I INFORMIMI	<ul style="list-style-type: none"> → Ndërmerr aktivitete në planin e edukimit të organeve kompetente për zbardhjen dhe ndjekjen e korrupsionit dhe llojeve tjera të krimit → E informon publikun për masat dhe aktivitetet e ndërmarra dhe për rezultatet e tyre

Për punën e vetë, KSHPK përgjigjet para Kuvendit, me paraqitjen e raportit vjetor për masat dhe aktivitetet e ndërmarra.



4. PERFORMANCA

Indikatorët për performancat janë definuar në mënyrë që të japin përgjigje se a i përmbush dhe sa i përmbush kompetencat KSHPK të cilat i takojnë me Ligjin për pengimin e korrupsionit, me Ligjin për pengimin e konfliktit të interesave dhe me Ligjin për mbrojtjen e lajmëtarëve. Indikatorët janë grupuar sipas katër grupeve themelore të kompetencave nëpërmjet të të cilave KSHPK mund ta realizojë rolin e vet preventiv dhe represiv në luftë kundër korrupsionit: krijimi i politikave kundër korrupsionit, mbikëqyrja dhe kontrolli, bashkëpunimi dhe edukimi dhe informimi.

4.1. KRIJIMI I STRATEGJIVE DHE POLITIKAVE KUNDËR KORRUPSIONIT

Kompetencat e dhëna ligjore nëpërmjet të të cilave KSHPK mund të jetë faktor në krijimin e strategjive dhe politikave kundër korrupsionit janë: hartimi i strategjisë shtetërore kundër korrupsionit, hartimi i raportit vjetor për punën e vet, realizimi i kontrollit kundër korrupsionit të legjislaturës dhe pjesëmarrja aktive në krijimin e politikës kundër korrupsionit.

Në bazë të planit vjetor të aktiviteteve të KSHPK dhe pas përfundimit të çdo viti kalendarik, KSHPK harton raportin vjetor për aktivitetet e veta. Raportin në afat prej 30 ditëve e dorëzon në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

Kontrolli kundër Korrupsionit në Legjislaturë (KKL) është njëra nga masat të cilat u përcaktuan në Planin e Aktiviteteve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në vitin 2015 për zbatimin e prioritetëve urgjente reformatore për Republikën e Maqedonisë. Në shkurt 2016 janë bërë ndryshime të Rregullores për Punën e Qeverisë, me të cilat të gjithë propozim-ligjet të cilët i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit të rregullores para se të dorëzohet në Qeveri për sjellje, domosdo duhet të dorëzohen edhe te KSHPK për mendim.

Në vijim paraqesim pasqyrën e të arriturave të deritanishme të indikatorëve për performancat lidhur me kompetencat e KSHPK sa i përket krijimit të politikave kundër korrupsionit.

**PERFORMANCAT E DERITANISHME LIDHUR ME
KRIJIMIN E POLITIKAVE KUNDËR KORRUPSIONIT**

INDIKATOR

GJENDJA E DERITANISHME

IP 1

**RAPORT VJETOR PËR
PUNËN E KSHPK**

Struktura e raporteve të KSHPK me vite ka vazhdimësi. Raportet i përmbajnë pjesët në vijim:

1. Statusi, kompetencat dhe buxheti i KSHPK;
2. Zbatimi i Ligjit për pengimin e korrupsionit me të cilin përfshihet realizimi i Programit Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit, veprimi mbi lëndët nga fusha e korrupsionit, evidentimi dhe ndjekja e gjendjes pronësore të personave të zgjedhur dhe të emëruar;
3. Puna në projekte;
4. Edukimi;
5. Bashkëpunimi me aktorë të tjerë;
6. Marrëdhënie me publikun;
7. Veprim në bazë të kërkesës për qasje deri te informatat me karakter publik.

Struktura e raportit i jep përgjigje realizimit të kompetencave të KSHPK. Por, me kalimin e viteve vërehet rënia e përmbajtjes së tekstit sa u përket detajeve. Sa për krahasim, në raportin vjetor për vitin 2009, në pjesën ku shqyrtohen lëndët për konflikt potencial të interesave, në mënyrë detale janë paraqitur të gjitha rastet në të cilat është konstatuar konflikt interesash, si dhe raste në të cilat nuk është konstatuar konflikt interesash. Në raportet e vitit 2012 shmanget kjo praktikë dhe të dhënat në lidhje me konfliktin e interesave përcakton sasinë, pa detaje.

Disa pjesë të caktuara të raporteve të cilat mund të kontribuojnë drejt shqyrtimit më të mirë të efekteve të punës së KSHPK të vitit 2011 nuk janë përfshirë. Shembull i tillë është pjesa e raportit të vitit 2009, në të cilin prezantohen efektet materiale të punës së KSHPK mbi lëndët. Që nga viti 2010 kjo nuk është pjesë e ndarë, por prezantohen informata në pjesë të ndryshme të raportit dhe si rezultat i kësaj, ndjekja e efekteve nga puna e KSHPK është e vështirësuar. Gjithashtu, edhe pjesa e ndarë për mendime mbi propozim ligje të rëndësishme për pengimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave gjendet në raportet e vitit 2012 dhe 2015.

Në këto raporte nuk ka klasifikim të niveleve të korrupsionit në lëndët të cilat i punon KSHPK.

INDIKATOR

GJENDJA E DERITANISHME

IP 2

DHËNIA E MENDIMIT
PËR PROPOZIME
TË RËNDËSISHME
PËR PENGIMIN E
KORRUPSIONIT

KSHPK deri në vitin 2011, në një pjesë të ndarë të raporteve vjetore i prezanton aktivitetet e veta lidhur me mendimet e dhëna dhe pjesëmarrjen në hartimin e ligjeve.

Nga viti 2006 deri në vitin 2011, KSHPK ka dhënë 54 mendime mbi propozim-ligje. Më së shumti (19) janë dhënë në vitin 2007 dhe më së paku (2) në vitin 2008. Në raportet janë dhënë edhe shembuj për pjesëmarrje në grupe punuese për hartimin e propozim-ligjeve dhe politikave.

Në raportet e vitit 2012 dhe të vitit 2015 nuk janë prezantuar informata lidhur me këtë indikator.

IP3

REALIZIMI I PROCESIT
TË KONTROLLIT KUNDËR
KORRUPSIONIT TË
LEGJISLACIONIT (KKKL)

Në shtator të vitit 2015 u soll Metodologjia për KKKL. Kjo metodologji e definon procesin e KKKL dhe rezultatet nga realizimi i procesit, organizatës dhe drejtimit të procesit, rolit dhe detyrave të çdo pjesëmarrësi në proces dhe inkuadrimit të palëve të prekura në proces. Sipas Metodologjisë, KSHPK duhet të hartojë një plan vjetor për realizimin e kontrollit kundër korrupsionit të legjislacionit dhe një plan dhe dinamikë të posaçme për zbatimin e kontrollit kundër korrupsionit të legjislacionit në bazë të projekt-ligjeve apo propozim-ligjeve të parashtruara dhe ligjeve që veç më janë sjellë. Në vitin 2016 u krijua Njësia për Kontrollin Kundër Korrupsionit të Legjislacionit, me pesë të punësuar.

4.2 MBIKËQYRJE DHE KONTROLL

KSHPK në pajtim me Ligjin për pengimin e korrupsionit mund të ketë një rol të rëndësishëm në eliminimin e korrupsionit në Republikën e Maqedonisë.

4.2.1. MASA DHE AKTIVITETE PËR PENGIMIN E KORRUPSIONIT NË PROCESIN ZGJEDHOR DHE TË PARTITË POLITIKE

Sa i përket rolit të KSHPK në mbikëqyrjen dhe kontrollin e shfrytëzimit të mjeteve buxhetore dhe mjeteve të fondeve publike për çfarëdo lloji të aktivitetit zgjedhor apo politik, ai ka mundësi t'i informojë organet kompetente në rast se konstaton se ekziston një dyshim i arsyeshëm për keqpërdorim. Në afat prej tre muajsh nga përfundimi i zgjedhjeve, KSHPK ka kompetenca të hartojë edhe një raport të posaçëm për keqpërdorimet e mundshme gjatë zgjedhjeve. Raportin e paraqet në Kuvend (neni 12, alineja 3), me ç'gjë sigurohet një bazë për kontrollin e punës së institucioneve të cilat janë informuar nga ana e KSHPK për ekzistimin e dyshimit për keqpërdorim të Buxhetit të RM nga ana e partive politike. KSHPK ka rolin e vet edhe në pengimin e korrupsionit gjatë dhe pas zgjedhjeve dhe nëpërmjet mundësisë për të ngritur iniciativa për përcaktimin e privilegjeve apo diskriminimit sa u përket

kontratave, furnizimeve publike dhe marrëveshjeve të tjera të personave juridik të vendit dhe të huaj. Në rast se konstaton privilegje apo diskriminim, nga institucionet kompetente kërkon të ndërmerren masa dhe aktivitete përkatëse. Për kontrollin e bërë, KSHPK në afat prej 30 ditëve i paraqet raport Kuvendit.

ARRITJET E DERITANISHME NË ZBATIMIN E MASAVE DHE AKTIVITETEVE PËR PENGIMIN E KORRUPSIONIT NË PROCESIN ZGJEDHOR DHE TE PARTITË POLITIKE

INDIKATOR	GJENDJA E DERITANISHME
IP 4 NDJEKJE E KEQPËRDORIMIT TË MJETEVE BUXHETORE, FONDEVE PUBLIKE DHE MJETEVE TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE DHE PERSONAVE TË TJERË JURIDIK TË CILËT DISPONOJNË ME KAPITAL SHETËTOR PËR FUSHATË ZGJEDHORE APO NË PËRGJITHËSI PËR FINANCIMIN E ZGJEDHJEVE DHE AKTIVITETEVE TË TJERA POLITIKE	KSHPK deri më tani ka konstatuar se ka ekzistuar bazë për dyshim për keqpërdorime të mundshme të mjeteve buxhetore, fondeve publike dhe mjeteve të ndërmarrjeve publike dhe personave të tjerë juridik të cilët disponojnë me kapital shtetëror, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, përmes punëve investuese apo në mënyrë tjetër, është shfrytëzuar për fushatë zgjedhore apo, në përgjithësi, për financim të aktiviteteve zgjedhore apo të tjera politike. Për këto arsye, nuk ka hartuar një raport të posaçëm për keqpërdorimet e mundshme të mjeteve buxhetore dhe fondeve publike gjatë zgjedhjeve. Nga viti 2006 deri në vitin 2015 në Maqedoni janë mbajtur: zgjedhje presidenciale në vitin 2009 dhe 2014, zgjedhje parlamentare në vitin 2006, 2008, 2011, 2014 dhe 2016 dhe zgjedhje lokale në vitin 2009 dhe 2013.
IP 5 NDJEKJA E RASTEVE PËR PRIVILEGJE APO DISKRIMIN SA U PËRKET MARRËVESHJEVE, FURNIZIMEVE PUBLIKE DHE MARRËVESHJEVE TË TJERA PAS ZGJEDHJEVE	KSHPK ka kompetencë ligjore të bëjë kontrollin e të gjitha kontratave, furnizimeve publike dhe marrëveshjeve të tjera që lidhen me krijimin e profitit, të bëra, gjegjësisht të realizuara, pas përfundimit të të gjitha niveleve të zgjedhjeve, mes organeve shtetërore, organeve të vetadministrimit lokal, ndërmarrjeve publike dhe personave të tjerë juridik, të cilët disponojnë me kapital shtetëror, me persona juridik të vendit apo të huaj, si dhe të gjitha lejet, koncesionet dhe vendimet e tjera me të cilat personave juridik u njihen të drejta apo privilegje të përcaktuara me ligj apo u merren ose u përkufizohen të drejtat dhe privilegjet e tilla. Pasi që deri më tani KSHPK për asnjë nga ciklet zgjedhore nuk ka konstatuar privilegje apo diskriminime sa u përket kontratave, furnizimeve publike dhe marrëveshjeve të tjera, nuk ka hartuar raport për rastet në të cilat ka konstatuar privilegje apo diskriminim pas përfundimit të zgjedhjeve, i cili paraqitet në Kuvend.

INDIKATOR

GJENDJA E DERITANISHME

IP 6

VEPRIM NË PENGIMIN E KORRUPSIONIT NË PROCESIN ZGJEDHOR

Në periudhën prej vitit 2006 deri në vitin 2015 u formuan gjithsej 5.098 lëndë me kërkesë për mendim për përdorimin e dispozitave të Ligjit për pengimin e korrupsionit dhe lidhur me realizimin e zgjedhjeve presidenciale në vitin 2009 dhe 2014, të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2008, 2011 dhe 2014 dhe të zgjedhjeve lokale të vitit 2009 dhe 2013.

Numri më i madh i lëndëve (2.615) u hap për zgjedhjet lokale të vitit 2013. Për këto zgjedhje kishte edhe gjithsej 109 lëndë të formuara sipas denoncimeve të partive politike, shoqatave, personave fizik dhe juridik, si dhe lëndë të hapura me iniciativë vetjake gjatë procesit zgjedhor.

IP 7

NGRITJA E INICIATIVAVE PARA ORGANEVE KOMPETENTE PËR KONTROLLIN E PUNËS FINANCIARE-MATERIALE TË PARTIVE POLITIKE

KSHPK nuk ka ngritur iniciativa para organeve kompetente për kontrollin e punës financiare-materiale të partive politike.

4.2.2. MASA DHE AKTIVITETE PËR PENGIMIN E KORRUPSIONIT DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË KRYERJEN E KOMPETEN- CAVE PUBLIKE TË PERSONAVE TË ZGJEDHUR DHE TË EMËRUAR

Në pajtim me Ligjin për pengimin e korrupsionit, KSHPK ka kompetenca për mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi funksionarët e zgjedhur dhe të emëruar, personave zyrtar apo personave përgjegjës në ndërmarrjet publike dhe persona të tjerë juridik, të cilët disponojnë me kapital shtetëror. Kështu, KSHPK mund të iniciojë një procedurë penale dhe shkarkim apo zëvendësim të një personi për të cilin do të konstatohet se, për shembull, e ka keqpërdorur pozitën dhe kompetencat zyrtare. KSHPK gjithashtu mund të veprojë edhe në raste kur do të konstatojë se ekziston konflikt i interesave publike dhe personale të një person të zgjedhur apo të emëruar.

Si institucion kompetent për mbajtjen e regjistrit të personave të zgjedhur dhe të emëruar dhe bazës së të dhënave për gjendjen e tyre pronësore, KSHPK mund të parashtrojë kërkesë deri te Drejtoria për të Hyra Publike për ngritjen e procedurës për kontrollimin e gjendjes pronësore në rast se një person i zgjedhur apo i emëruar nuk e ka dorëzuar fletën anketuese apo në fletën anketuese nuk ka paraqitur të dhëna, ka paraqitur të dhëna të pavërteta apo jo të plota apo nuk ka paraqitur ndryshime të pronës. Procedurën pastaj e udhëheqë Drejtoria e të Ardhurave Publike.

TË ARRITURAT E DERITANISHME NË ZBATIMIN E MASAVE DHE AKTIVITETEVE PËR PENGIMIN E KORRUPSIONIT DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË KRYERJEN E AUTORIZIMEVE PUBLIKE TË PERSONAVE TË ZGJEDHUR DHE TË EMËRUAR

INDIKATOR

GJENDJA E DERITANISHME

IP 8

NGRITJA E INICIATIVAVE PËR NISJEN E PROCEDURËS PARA ORGANEVE KOMPETENTE PËR PUSHIM NGA PUNA, ZHVENDOSJE, ZËVENDËSIM APO MARRJA E MASAVE TË TJERA TË PËRGJEGJËSISË TË PERSONAVE TË ZGJEDHUR APO TË EMËRUAR, TË PERSONAVE ZYRTAR APO PERSONAVE PËRGJEGJËS NË NDËRMARRJET PUBLIKE DHE PERSONA TË TJERË JURIDIK TË CILËT DISPONOJNË ME KAPITAL SHTETËROR

Sipas të dhënave të paraqitura në raportet vjetore të KSHPK në bazë të nenit 49 paragrafi 1 alineja 5, ka ngritur 34 iniciativa për ngritjen e lëndëve para organeve kompetente për pushim nga puna, zhvendosje, zëvendësim apo ndërmarrje masash të tjera të përgjegjësishë. Këto 34 iniciativa kanë të bëjnë me lëndë të ngritura kundër 21 personave të zgjedhur apo të emëruar dhe 5 procedura të cilat përfshijnë më shumë persona të tjerë përgjegjës. Nga këta 21 persona, sipas klasifikimit në nivelin e korrupsionit, gjashtë persona janë akuzuar për korrupsion të lartë, tetë për korrupsion të mesëm dhe shtatë për korrupsion në nivel të ulët. Të gjashtë rastet e nivelit të lartë u ngritën në vitin 2007 dhe 2008 nga të cilët pesë lëndë ishin kundër gjykatësve dhe një kundër një prokurori publik.

KSHPK nuk ka (e as që mund të përcaktojë) informata për lartësinë e dëmit nga dyshimet me arsye dhe/ose keqpërdorimi i konfirmuar i buxhetit, i institucioneve ku është konfirmuar, shfrytëzuesve të shërbimeve, qytetarëve, cilësisë së punës së institucionit.

IP 9

NGRITJA E INICIATIVAVE PËR NISJEN E PROCEDURËS PËR NDJEKJE PENALE TË PERSONAVE TË ZGJEDHUR DHE TË EMËRUAR, PERSONAVE ZYRTAR APO PERSONAVE PËRGJEGJËS NË NDËRMARRJE PUBLIKE, PERSONA TË TJERË JURIDIK QË DISPONOJNË ME KAPITAL SHTETËROR

Sipas të dhënave të paraqitura në raportet vjetore të KSHPK nga viti 2007 deri në vitin 2015, KSHPK në bazë të nenit 49 paragrafi 1 alineja 6, ka ngritur 102 iniciativa për nisjen e procedurës para organeve kompetente për ndjekje penale, të cilat kanë të bëjnë me 96 persona dhe 74 lëndë të cilat përfshijnë më shumë persona përgjegjës. Nga këta 96 persona të zgjedhur dhe të emëruar, dy kanë qenë në nivel të lartë, 59 në nivel të mesëm dhe 35 në nivel të ulët. Dy rastet e nivelit të lartë janë ngritur në vitin 2010 kundër persona më par të zgjedhur dhe të emëruar (një president shteti dhe një ministër i bujqësisë, pylltarisë dhe ujit). Për këto dy raste në raporte nuk janë paraqitur dëmet e vlerësuara të buxhetit. Më së shumti iniciativa (27) janë ngritur në vitin 2008, ndërsa më së paku (2) në vitin 2015.

KSHPK nuk ka (as që mund të përcaktojë) informata për lartësinë e dëmit të keqpërdorimit të dyshuar dhe/ose të konfirmuar të buxhetit, të institucioneve ku është konfirmuar, shfrytëzuesve të shërbimeve, qytetarëve, cilësisë së punës së institucioneve.

IP 10

EVIDENTIMI DHE NDJEKJA E FLETËVE ANKETUESE DHE FLETËPARAQITJEVE PËR NDRYSHIM NË GJENDJEN PRONËSORE TË PERSONAVE TË ZGJEDHUR DHE EMËRUAR, TË PERSONIT PËRGJEGËS NË NDËRMARRJE PUBLIKE, INSTITUCIONI PUBLIK APO NJË PERSON TJETËR JURIDIK I CILI DISPONON ME KAPITAL SHTETËROR.

Nga viti 2006 deri në vitin 2015 mesatarisht në vit janë paraqitur 950 fletë anketuese. Më së paku (451) fletë anketuese janë paraqitur në vitin 2008, ndërsa më së shumti (2.170) në vitin 2013, falë zgjedhjeve lokale.

Numri i përgjithshëm i fletëve anketuese të publikuara të personave aktualisht të zgjedhur apo të emëruar në ueb-faqe sillet prej 1.483 në vitin 2009, deri në 4.390 në vitin 2015. Në Shtojcën 1 është dhënë pasqyra detale e strukturës së fletëve anketuese të paraqitura.

Nga viti 2011 KSHPK filloi me aktivitete për përmirësimin e procedurave për verifikimin dhe ndjekjen e gjendjes pronësore të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar. KSHPK hartoi dhe solli “Kritere për mënyrën për përcaktimin e fletëve anketuese të cilat do të jenë objekt i kontrollit”, por ky dokument nuk bëhet publik. Fletët anketuese të cilat janë objekt i kontrollit ndahen në bartës të funksioneve publike të pushtetit ligjvënës, të pushtetit ekzekutiv, të pushtetit gjyqësor dhe të vetadministrimit lokal. Në vitin 2011 u kontrolluan fletët anketuese të 126 personave, 85 në vitin 2012, nga 34 në vitin 2013 dhe 2014 dhe 43 në vitin 2015. Kjo do të thotë se nga mesatarisht të paraqitura 950 fletë anketuese – KSHPK në vitin 2011 ka kontrolluar 13%, në vitin 2012 8%, në vitin 2013 dhe 2014 nga 3% dhe në vitin 2015 4%.

Nga viti 2006 deri në vitin 2015, KSHPK ka paraqitur 332 kërkesa për ngritjen e procedurave kundërvajtëse për shkak të mungesës së fletës anketuese. Më së shumti (58) kërkesa KSHPK ka paraqitur në vitin 2008, ndërsa më së paku (7) në vitin 2015.

Nga viti 2006 deri në vitin 2015 deri te Drejtoria për të Ardhura Publike, KSHPK ka paraqitur 243 kërkesa për nisje të procedurës për kontrollin e pronës dhe gjendjes pronësore të personave të zgjedhur dhe të emëruar. Në vitin 2014 ka paraqitur më së shumti kërkesa (48), ndërsa më së paku (2) në vitin 2012.

Nga të gjitha procedurave të nisura, kanë përfunduar 83, ndërsa 133 janë ndërprerë.

Në periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2009, në Buxhetin e RM janë kthyer mjete në lartësi prej 77.468.333 denarë nga procedurat të cila KSHPK ka iniciuar para institucioneve të tjera, ndërsa në bazë të TVSH-së së papaguar, janë vënë gjoba në të holla për mosplotësimin e obligimit ligjor për fletët anketuese, të të ardhurave të paparaqitura dhe të patatimuara etj. Nga viti 2010 deri në vitin 2015, vlera e përgjithshme e huas për grumbullimin e tatimit nga ana e DAP dhe me iniciativë të KSHPK është pothuajse 20.000.000 denarë. Më së shumti janë grumbulluar në vitin 2014 – 9.443.560 denarë, në dy lëndë, ndërsa më së paku në vitin 2010 – 216.497 denarë.

IP 11**NISJA E PROCEDURAVE
NË RASTE TË
KONFLIKTIT TË
INTERESAVE**

Më 18.09.2009 hyri në fuqi Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për pengimin e konfliktit të interesave. Në pajtim me ndryshimet, u vendos obligimi për funksionarët publik për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës për interesat.

Në periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2015, sipas informatave të disponueshme në raportet vjetore, KSHPK ka hapur 1.056 lëndë nga fusha e konfliktit të interesave, ndërsa kanë përfunduar 941 (apo 89%) prej tyre. Nga lëndët për të cilat ka vepruar në këtë periudhë, KSHPK në 356 lëndë ka konstatuar ekzistimin e gjendjes së konfliktit të interesave, nga të cilat në 86 lëndë të personave zyrtar u është vënë masa e vërejtjes publike për shkak të mosveprimit ndaj kërkesave dhe sugjerimeve të KSHPK.

Në këtë raport nuk është bërë analiza se a ka nisur KSHPK procedura në të gjitha rastet në të cilat kanë ekzistuar baza për konflikt interesash. Në bazë të të dhënave të disponueshme në ueb-faqe, më tej në raport jepet klasifikimi i niveleve të rasteve të ngritura për konflikt interesash.

IP 12

TËRËSIA DHE
AKTUALITETI I TË
DHËNAVE NGA
REGJISTRI I PERSONAVE
TË ZGJEDHUR DHE TË
EMËRUAR

Regjistri për persona të zgjedhur dhe të emëruar është vënë në funksion më 12.06.2016.

Të dhëna për të gjithë personat e zgjedhur dhe të emëruar të disponueshëm në regjister përmbajnë: emri dhe mbiemri i personit, emri i organit ku kryhet funksioni/detyra, emri i funksionit/detyrës dhe data e zgjedhjes/përfundimit.

Regjistri është pjesërisht i azhurnuar, në pajtim me të dhënat të cilat KSHPK-së ia kanë dorëzuar institucionet dhe individët e obliguar. Gjatë filtrimit të të dhënave për funksionin “Kryetar Komune”, rezultati jep 38 shënime, ndërsa ka 81 njësi të vetadministrimit lokal. Nuk ka informata për atë se kush e kryen funksionin kryetar i Qeverisë së RM dhe për ministrat. Në shënimet për personat të cilët i kryejnë për momentin këto funksione, qëndron funksioni deputet, në të cilin ata kanë hyrë në fuqi më 30.12.2016.

KSHPK ka kompetenca që nga gjyqi kompetent të kërkojë nisjen e procedurës kundërvajtëse për personin udhëheqës të institucionit ose organit i cili bën zgjedhje dhe emërime, gjegjësisht të personit të autorizuar prej tij, në rast se në afat prej 15 ditëve nga dita e verifikimit të mandatit, zgjedhja, gjegjësisht emërimi, si dhe pas përfundimit të funksionit të personit të zgjedhur dhe emëruar nuk dorëzon formularë të plotësuar deri te KSHPK.

Regjistri i personave të zgjedhur dhe emëruar nuk është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me të dhënat e fletëve anketuese për gjendjen pronësore të personave të zgjedhur dhe të emëruar.

INDIKATOR

GJENDJA E DERITANISHME

IP 13

VEPRIMI NË BAZË TË
DENONCIMIT PËR
PJESËMARRJE NË
PRONË APO PËR
AKSIONE.

Në raportet e veta, KSHPK nuk ka informata për veprime mbi bazë të denoncimeve për pjesëmarrje në pronë apo për aksione.

IP 14

VEPRIM NË BAZË TË DENONCIMEVE PËR EKZISTIMIN E KORRUPSIONIT NGA ANA E QYTETARËVE APO PERSONAVE JURIDIK TË PAKËNAQUR NGA VENDIMI I SJELLË, NË BAZË TË AUTORIZIMIT DISKRECONAL DHE TË CILËT KONSIDEROJNË SE KY VENDIM ËSHTË SJELLË PËR SHKAK TË KORRUPIMIT.

Në raportet e veta, KSHPK nuk ka informata për ekzistimin e rasteve kur qytetarë apo persona juridik kanë bërë denoncim deri te KSHPK si të pakënaqur nga vendimi i sjellë në bazë të autorizimeve diskrecionale dhe të cilët konsiderojnë se ky vendim është sjellë për shkak të korruptimit.

4.2.3. MASA DHE AKTIVITETE PËR PENGIMIN E KORRUPSIONIT NË SINDIKATA DHE SHOQATA DHE FONDACIONE

Masa nëpërmjet së cilës KSHPK mund ta kryejë rolin e vet në pengimin e korruptimit është edhe inicimi i kontrollit të punës financuese-materiale e sindikatave, të shoqatave dhe fondacioneve.

ARRITJET E DERITANISHME NË ZBATIMIN E MASAVE DHE AKTIVITETEVE PËR PENGIMIN E KORRUPSIONIT NË SINDIKATAT DHE SHOQATAT DHE FONDACIONET

ИНДИКАТОР

GJENDJA E DERITANISHME

IP 15

NISJA E INICIATIVËS PARA ORGANEVE KOMPETENTE PËR KONTROLL TË PUNËS FINANCIARE-MATERIALE TË SINDIKATAVE

Sipas informatave të disponueshme në raportet vjetore, KSHPK nuk ka ngritur iniciativë para organeve kompetente për kontroll të punës financiare-materiale të sindikatave.

IP 16

NGRIT INICIATIVA PARA ORGANEVE KOMPETENTE PËR KONTROLL TË PUNËS FINANCIARE-MATERIALE TË SHOQATAVE DHE FONDACIONEVE

Sipas informatave të disponueshme në raportin vjetor, KSHPK nuk ka nisur iniciativa para organeve kompetente për kontroll të punës financiare-materiale të shoqatave dhe institucioneve.

4.2.4. MASA DHE AKTIVITETE PËR REALIZIMIN E PROCEDURËS PËR MBROJTJEN E LAJMËTARËVE

ARRITJET E DERITANISHME NË MBIKËQYRJEN DHE KONTROLLIN MBI REALIZIMIN E MBROJTJES SË LAJMËTARËVE

INDIKATOR	GJENDJA E DERITANISHME
IP 17 AKTIVITETE DHE MASA TË NDËRMARRA NGA KSHPK SI PËRGJIGJE NDAJ DENONCIMEVE NGA ANA E LAJMËTARËVE.	Ligji i ri për mbrojtjen e lajmëtarëve është sjellë në nëntor 2015, ndërsa zbatohet nga marsi 2016.

4.2.5. MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI NË BAZË TË DENONCIMEVE TË PRANUARA

ARRITJE TË DERITANISHME NË MBIKËQYRJEN DHE KONTROLLIN NË BAZË TË DENONCIMEVE TË PRANUARA

INDIKATOR	GJENDJA E DERITANISHME
IP 18 DENONCIME NGA QYTETARË DHE PERSONA JURIDIK	<p>Nga viti 2006 deri në vitin 2015 ekzistojnë dallime në mënyrën e prezantimit të të dhënave, kështu që grumbullimi i të gjitha denoncimeve të pranuar nga ana e qytetarëve është i vështirësuar. Nga të dhënat e disponueshme, më së shumti (1.114) denoncime nga ana e qytetarëve ka pasur në vitin 2007, ndërsa më së paku (127) në vitin 2015.</p> <p>Në raportet vjetore, KSHPK nuk prezanton të dhëna analitike për strukturën e denoncuesve (qytetarë, persona juridik, shoqata etj.)</p>

4.3. BASHKËPUNIMI

Ekzistojnë tri palë kyçe të prekura në nivel institucional, të cilat në një masë të konsiderueshme mund të kontribuojnë për punë efikase të KSHPK: institucionet shtetërore, sektori privat dhe shoqatat qytetare.

Krahas obligimeve të përcaktuara ligjore, bashkëpunimi me KSHPK me institucione të tjera shtetërore është i rregulluar edhe me Udhëzimin për bashkëpunim të organeve të administratës shtetërore, ndërmarrjeve publike, institucioneve publike dhe personave të tjerë juridik të cilët disponojnë me kapital shtetëror me Komisionin Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 81/2004 dhe 135/2006), të sjellë nga Qeveria. Sipas Udhëzimit, bashkëpunimi me institucionet e KSHPK nënkupton vendosje të suksesshme, koordinim dhe mbajtje të komunikacioneve, si dhe këmbim i shpejtë dhe i sigurt i informatave, këmbim i diturive profesionale, shkencore dhe teknike, si dhe këmbim i informatave për persona për të cilat ekziston dyshimi se kanë shkelë Ligjin për pengimin e korrupsionit. Të gjitha institucionet, të përfshira me këtë Udhëzim, kanë për obligim në afat prej 15 ditëve të veprojnë në bazë të kërkesës së dorëzuar nga ana e KSHPK. Në rast të mosveprimit, mund të ngrihen masa për shkeljen e obligimeve në kryerjen e obligimeve zyrtare dhe punuese të personave përgjegjës në institucion i cili nuk e përmbush kërkesën e KSHPK.

Nga dhjetori 2007 e këtej, bashkëpunimi i KSHPK me 17 institucione⁴ realizohet edhe në bazë të Protokollit të nënshkruar për bashkëpunim dhe preventivë dhe represion të korrupsionit dhe konfliktit të interesit.⁵

Me qëllim të përforcimit të bashkëpunimit me shoqatat qytetare, në dhjetor 2010 KSHPK e nënshkroi Memorandumin për përkrahje të ndërsjellë për pengimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit me shoqatat qytetare. Deri në përfundimin e vitit 2014, gjithsej 22 organizata iu bashkëngjiten Memorandumit.

KSHPK më 9 dhjetor 2011 e nënshkroi edhe Memorandumin për përkrahje të ndërsjellë për pengimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit me sektorin privat. Nënshkrues të Memorandumit janë nëntë oda ekonomike dhe shoqata të cilat punojnë me çështje lidhur me sektorin afarist.

5 Drejtoria për të Ardhura Publike, Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë, Prokuroria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë, Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Enti Shtetëror për Revizion, Drejtoria Doganore, Drejtoria për Pengimin e Larjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit (tani: Drejtoria për Zbulim Financiar), Drejtoria për Polici Financiare, Enti Shtetëror për Punë Gjeodezike (tani: Agjencia për Kadastër të Patundshmërive), Këshilli i Prokurorëve Publik i RM, Këshilli për Radiodifuzion (tani: Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audio-Vizuale), Byroja për Furnizime Publike, Komisioni Shtetëror Zgjedhor, Komisioni Shtetëror për Ankesa për Furnizimet Publike, Regjistri Qendror i RM dhe Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

ARRITJET E DERITANISHME NË BASHKËPUNIMIN ME INSTITUCIONET SHETËTORRE, ORGANIZATAT QYTETARE DHE SEKTORI PRIVAT

INDIKATOR

IP 19

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET NË MAQEDONI DHE JASHTË VENDIT

GJENDJA E DERITANISHME

Në programet vjetore për punën nga viti 2011 deri në vitin 2015, me qëllim të avancimit të bashkëpunimit me institucionet shtetërore, janë planifikuar takime të rregullta tremujore me nënshkruesit e Protokollit për bashkëpunim.

Në raportet vjetore për punën nga viti 2010 deri në vitin 2013 ka informata për 14 takime punuese të mbajtura me institucione shtetërore, ndërsa në raportet për vitin 2014 dhe 2015 nuk ka informacione për takime të mbajtura dhe aktivitete konkrete për bashkëpunim.

KSHPK është duke hartuar raporte për realizimin e Protokollit për bashkëpunim për preventivë dhe represion të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Disa nga shembujt e bashkëpunimit me institucionet shtetërore janë:

Takime punuese të mbajtura gjatë vitit 2013 me Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë, në të cilat janë shqyrtuar më shumë çështje në lidhje me iniciativën për ndjekje penale të KSHPK dhe veprimit të Prokurorisë Publike;

Në vitin 2013, pas përfundimit të zgjedhjeve lokale, KSHPK inicioi takim me përfaqësuesit më të lartë të Komisionit Shtetëror Zgjedhor dhe të Entit Shtetëror për Revizion;

Në maj 2103, në bashkëpunim me Drejtorinë për të Ardhura Publike u realizuan trajnimet për edukim dhe ngritje të vetëdijes te kuadrot e DAP për njohje, preventivë dhe represion të korrupsionit dhe pengimin e konfliktit të interesave, si dhe prezantim të sistemit të integritit.

Për periudhën nga janari deri në qershor 2013 është hartuar Raporti për Realizimin e Protokollit për Bashkëpunim me Institucionet Shtetërore.

Për raportet nga viti 2006 deri në vitin 2011 ka një pjesë të veçantë e cila ka të bëjë me bashkëpunimin ndërkombëtar. Në këtë periudhë: janë nënshkruar tre memorandume për bashkëpunim, anëtarë të KSHPK dhe të Sekretariatit kanë marrë pjesë në 29 konferenca, 10 seminare dhe 4 trajnime jashtë Maqedonisë. Janë realizuar edhe 13 vizita studimore te institucione të ngjashme dhe janë mbajtur 20 takime pune. Në raportet nga viti 2012 deri në vitin 2015 nuk ka pjesë e posaçme e cila ka të bëjë me bashkëpunimin ndërkombëtar, por ka informata për dy memorandume të nënshkruara për bashkëpunim dhe nga një pjesëmarrje në konferencë dhe punëtori. Informatat në këto raporte janë të përgjithshme.

INDIKATOR

IP 20

REALIZIMI I
AKTIVITETEVE
NË KUADËR TË
MEMORANDUMIT
PËR BASHKËPUNIM
NË LUFTËN KUNDËR
KORRUPSIONIT
DHE KONFLIKTIT
TË INTERESAVE ME
SEKTORIN QYTETAR

GJENDJA E DERITANISHME

Në programet vjetore për punën nga viti 2011 deri në vitin 2015, me qëllim të avancimit të bashkëpunimit është planifikuar mbajtja e rregullt e takimeve tremujore me nënshkruarit e Memorandumit. Në raportet vjetore, KSHPK nuk prezanton informata dhe të dhëna konkrete për arritjet e këtij aktiviteti, me numrin e mbledhjeve të mbajtura, numrin e organizatave të cilat kanë marrë pjesë dhe temat për të cilat është biseduar. S'ka informata për numrin e përfaqësuesve të organizatave qytetare të pranishme në ngjarjet e KSHPK.

Në raportet vjetore nga viti 2010 deri në vitin 2014 një pjesë e veçantë e raporteve i është përkushtuar bashkëpunimit me organizatat qytetare, në bazë të Memorandumit të nënshkruar. Disa nga rastet e bashkëpunimit me organizatat qytetare të paraqitura në këto raporte janë:

- Pjesëmarrja e një përfaqësuesi të KSHPK në funksion të ligjëruesit të një trajnimi në fushën e korrupsionit në arsimin e lartë, i organizuar nga ana e Forumit Rinor Arsimit në prill të vitit 2014;
- Inkuadrimi në Qendrën për Komunikime Qytetare në projektin në vitin 2012, të cilin KSHPK e realizon në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe me Byronë për Zhvillim të Arsimit për kycjen e përmbajtjeve kundër korrupsionit në sistemin arsimor në Maqedoni.

Në raportin për vitin 2015 nuk ka informata për aktivitete konkrete për bashkëpunim me organizatat qytetare.

Për periudhën nga janari deri në qershor 2013 është hartuar edhe raporti me organizatat qytetare.

IP 21

REALIZIMI I
AKTIVITETEVE
NË KUADËR TË
MEMORANDUMIT
PËR BASHKËPUNIM
NË LUFTËN KUNDËR
KORRUPSIONIT
DHE KONFLIKTIT
TË INTERESAVE NË
SEKTORIN PRIVAT

Në programet vjetore për bashkëpunim nga viti 2011 deri në vitin 2015, me qëllim të avancimit të bashkëpunimit është planifikuar mbajtja e takimeve tremujore të rregullta me nënshkruesit e Memorandumit. Edhe pse në raportet vjetore nga viti 2011 deri në vitin 2014 një pjesë e posaçme i është përkushtuar bashkëpunimit me sektorin privat, KSHPK nuk prezanton informata dhe të dhëna për arritje për këtë aktivitet me numrin e takimeve të mbajtura, numrin e institucioneve/organizatave të cilat kanë marrë pjesë dhe për temat për të cilat është biseduar. Nuk ka informata për numrin e përfaqësuesve të sektorit privat të pranishëm në ngjarjet e KSHPK. Disa nga shembujt e bashkëpunimit me sektorin privat të paraqitura në këtë raport janë:

- Në vitin 2012 u realizuan më shumë aktivitete me Konfederatën e Biznesit të Maqedonisë. Si rezultat i këtij bashkëpunimi doli Kodeksi i Etikës në Biznes, si udhëheqës për Bashkësinë Afariste të Maqedonisë;
- Në vitin 2014, KSHPK mori pjesë në sjelljen e kodeksit të sjelljes për kryerjen korrekte, të ndërgjegjshme dhe të drejtë të aktiviteteve në sektorin privat, për pengimin e konfliktit të interesave dhe për zbatimin e praktikave të mira në bashkëpunim me subjektet shtetërore dhe private dhe në realizimin e hulumtimeve për korrupsion në sektorin privat dhe trajnime me përfaqësues me këtë sektor për forcimin e integritetit.

Në raportin vjetor për vitin 2013 dhe 2015 nuk ka informata për aktivitete konkrete për bashkëpunim me sektorin privat.

Për periudhën janar-qershor 2013 është hartuar raporti për bashkëpunim me sektorin privat.

QËNDRIMET E ORGANIZATAVE QYTETARE PËR REALIZIMIN E MEMORANDUMIT PËR PÛRKRAHJE TË NDËRSJELLË

Sipas organizatave, bashkëpunimi me KSHPK në të shumtën e rasteve ka të bëjë me mbajtjen e takimeve (64%). Në bazë të Memorandumit, organizatat dhe KSHPK më së paku kanë bashkëpunuar rreth çështjeve lidhur me bashkëpunimin profesional gjatë hartimit të rregullores së nevojshme ligjore dhe ndonjë rregullore tjetër, e cila e trajton materien e fushës së korrupsionit dhe konfliktit të interesave (23%). Në tabelën 3 janë dhënë përgjigje të organizatave për të praktikuarit e llojeve të bashkëpunimit të paraqitura në nenin 3 të Memorandumit.

TABELA NR.3 - BASHKËPUNIMI RRETH PIKAVE TË PARAQITURA NË NENIN 3 TË MEMORANDUMIT PËR BASHKËPUNIM

Ju lutemi përgjigjuni se nga nënshkrimi i Memorandumit në vitin 2010 deri më 31 dhjetor 2016 a keni bashkëpunuar me KSHPK rreth ndonjë pike të përfshirë në nenin 3 të Memorandumit!	Да	Не
Këmbimi i informatave në dispozicion dhe iniciativave nga fusha e korrupsionit dhe konfliktit të interesave	43%	57%
Analiza dhe hulumtime të korrupsionit dhe konfliktit të interesave	29%	71%
Mbajtja e takimeve mes KSHPK dhe përfaqësuesve të organizatave joqeveritare	64%	36%
Bashkëpunimi në realizimin e debateve publike, punëtori, konferenca dhe fushata për ngritjen e vetëdijes publike	43%	57%
Bashkëpunim i ndërsjellë profesional në procesin e edukimit dhe trajnimit në fushën e korrupsionit dhe konfliktit të interesave	43%	57%
Bashkëpunim i ndërsjellë profesional gjatë hartimit të rregullores së nevojshme ligjore dhe ndonjë rregullore tjetër e cila trajton materie nga fusha e korrupsionit dhe konfliktit të interesave	21%	79%
Bashkëpunim për shkak të realizimit të projekteve nga interesi për luftë kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave	50%	50%

Bashkëpunimi me KSHPK në 50% të rasteve ka qenë iniciativë e organizatave, ndërsa vetëm tri (21%) organizata janë deklaruar se KSHPK u është drejtuar me iniciativë për bashkëpunim.

Iniciativat e organizatave në të shumtën e rasteve kanë të bëjnë me bashkëpunim në kornizën normative lidhur me luftën kundër korrupsionit, organizimin e ngjarjeve, bashkëpunimin në projekte dhe përgatitje të analizave dhe hulumtimeve. Nga shembujt të cilët i kanë paraqitur organizatat, KSHPK ka pranuar 60% të iniciativave të propozuara nga ana e organizatave. Iniciativat e pranuar për bashkëpunim kanë të bëjnë me pjesëmarrje në trajnime dhe me ngjarje të organizuara nga ana

e organizatave qytetare dhe me këmbimin e informatave për hartimin e analizave. Gjithashtu, sipas deklarimeve të organizatave, në rast se KSHPK i ka refuzuar iniciativat e tyre, arsyet nuk kanë qenë të sqaruara në mënyrë të argumentuar. Nga ana tjetër, organizatat i kanë pranuar pothuajse të gjitha iniciativat për bashkëpunim të cilat ua ka ofruar KSHPK. Vetëm në një rast iniciativa nuk është pranuar. Si shembuj për iniciativat të drejtuara për KSHPK përmenden ftesa për pjesëmarrje në grup pune, pjesëmarrje në takime të organizatave qytetare, organizimi i përbashkët në konsultime për hartimin e Programit Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave (2016-2019).

Të pyetur se si e vlerësojnë bashkëpunimin e përgjithshëm, 29% të organizatave janë shprehur se nuk kanë pasur bashkëpunim, 43% se kanë pasur bashkëpunim, por jo në nivelin e kënaqshëm. Për vetëm 29% të organizatave bashkëpunimi ka qenë i mirë, por se duhet të përmirësohet. Asnjë organizatë bashkëpunimin nuk e ka vlerësuar si të shkëlqyeshme.

4.4. EDUKIMI

Nëpërmjet edukimit të organeve kompetente për zbardhjen dhe ndjekjen e korrupsionit dhe llojeve të tjera të krimit, KSHPK mund të kontribuojë drejt forcimit të kapaciteteve të organeve të drejtorisë shtetërore⁶.

ARRITJE TË DERITANISHME NË EDUKIM

INDIKATOR	GJENDJA E DERITANISHME
<p>IP 22 AKTIVITETE TË NDËRMARRA NË PLANIN E EDUKIMIT TË ORGANEVE KOMPETENTE PËR ZBULIMIN DHE NDJEKJEN E KORRUPSIONIT DHE LLOJEVE TË TJERA TË KRIMIT</p>	<p>Në raportet vjetore për vitin 2006 dhe 2007, nuk ka informata për aktivitete të realizuara në planin e edukimit. Sipas informatave të raporteve vjetore nga viti 2008 deri në vitin 2015, në bashkëpunim me institucionet e tjera janë mbajtur gjithsej 80 trajnime.</p> <p>Në periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2010 me trajnime janë përfshirë 500 gjykatës dhe prokurorë publik dhe rreth 80 nëpunës të tjerë. Në raportet nga viti 2011 deri në vitin 2015 nuk është dhënë numri i pjesëmarrësve në trajnimet të cilat i ka realizuar KSHPK.</p> <p>Një pjesë e temave të përfshira me trajnimet janë: “Korrupsioni dhe konflikti i interesave: njohje dhe tejkalim; Transparenca në funksion të preventivës së korrupsionit në gjyqësi; Masat kundër korrupsionit dhe etika në shërbimin shtetëror; Ryshfet aktiv dhe pasiv nëpërmjet konceptit të personit zyrtar.</p>

⁶ Ligji për pengimin e korrupsionit, neni 49 paragrafi 1 alineja 10

4.5. KONKLUZIONE PËR PERFORMANCAT

Nga 22 INDIKATORË të përgjithshëm të cilët janë definuar për vlerësimin e performancave të KSHPK, tre janë realizuar në pajtim me kompetencat e dhëna ligjore, te 11 INDIKATORË kompetencat plotësohen, por pamjaftueshëm ose në mënyrë joadekuate dhe për shtatë INDIKATORË kompetencat e dhëna me ligj nuk plotësohen. Nga informatat e disponueshme, për një pjesë të kompetencave të papërbushura nuk mund në mënyrë të qartë të përcaktohen arsyet, gjegjësisht se a kanë ekzistuar baza për veprim dhe nuk është vepruar apo nuk kanë ekzistuar fare baza për t'u ndërmarrë aktivitete.

Edukimi i institucioneve është arritja kyçe e KSHPK. Kompetencat të cilat plotësohen kanë të bëjnë para së gjithash me edukimin e institucioneve, si dhe me bashkëpunimin me ta, e në bazë të Protokollit për Bashkëpunim të nënshkruar.

Ndjekja e konfliktit të interesave në fokus të punës së KSHPK. Krahas edukimit, KSHPK është aktiv edhe në ndjekjen e konfliktit të interesave. Për një periudhë prej tetë vjet, KSHPK ka hapur 1.056 lëndë nga fusha e konfliktit të interesave dhe ka zgjidhur 89% prej tyre, gjegjësisht 941 lëndë. Në 356 raste ka konstatuar ekzistimin e gjendjes së konfliktit të interesit.

Ekziston dështim në kompetencat mbikëqyrëse dhe kontrolluese. Më së paku arritje ka te kompetencat lidhur me mbikëqyrjen dhe kontrollin, edhe atë kompetencat të cilat i kanë lidhur me ndjekjen e keqpërdorimeve potenciale gjatë zgjedhjeve dhe mbikëqyrjes së partive politike. Kështu, për shembull, edhe pse KSHPK mundet në masë të konsiderueshme të kontribuojë në luftën kundër korrupsionit në procesin zgjedhor, deri më tani kurrë nuk ka hartuar një raport të ndarë për keqpërdorimet e mundshme të mjeteve buxhetore dhe mjeteve të fondeve publike për fushatë zgjedhore apo në përgjithësi për financimin e një aktiviteti zgjedhor apo aktivitet tjetër politik, sepse nuk ka konstatuar se ka pasur keqpërdorime të tilla në zgjedhjet e realizuara nga viti 2006 deri në vitin 2015. Kjo është njëra nga kompetencat nëpërmjet të cilave KSHPK mund të kontribuojë në masë të madhe në luftën kundër korrupsionit në procesin zgjedhor.

KSHPK vëren një rënie të performancave të veta edhe në evidentimin dhe ndjekjen e gjendjes pronësore të personave të zgjedhur dhe të emëruar. Në vazhdimësi ulet numri i fletëve anketuese të kontrolluara – nga 126 personave të kontrolluar në vitin 2011, deri në 43 në vitin 2015. Ulet edhe numri i kërkesave për ngritjen e procedurave kundërvajtëse për shkak të mosdorëzimit të fletëve anketuese, gjegjësisht më së shumti (58) kërkesa KSHPK ka paraqitur në vitin 2008, ndërsa më së paku (7) në vitin 2015. Gjithashtu ulet numri i kërkesave për kontrollin e gjendjes pronësore dhe iniciativave të ngritura për nisjen e procedurës para organeve kompetente për ndjekje penale të një personi të zgjedhur dhe të emëruar. Nga 102 iniciativa të ngritura për ndjekje penale në periudhën nga vitin 2007 deri në vitin 2015, më së shumti janë ngritur në vitin 2008, e më së paku (2) në vitin 2015. Këto iniciativa përfshinë procedura kundër gjithsej 96 personave dhe 74 procedura kundër grupe personash. Nga këto 96, dy persona kanë qenë në pozitë të lartë, 59 në nivel të mesëm dhe 35 në nivel të ulët.

Nga qershori 2016 u vendos edhe Regjistri i personave të emëruar dhe të zgjedhur, i cili azhurnohet në bazë të të dhënave të fituara nga institucionet të cilat kryejnë zgjedhje

dhe emërimet. Regjistri nuk është azhurnuar sepse institucionet nuk i dorëzojnë të dhënat me kohë. Por, KSHPK nuk ka ngritur procedurë para gjyqeve kompetente për gjëritje të institucioneve dhe të personave përgjegjës në institucionet të cilat nuk kanë dorëzuar formularë të plotësuar për persona të zgjedhur dhe të emëruar.

Ulje e konsiderueshme e denoncimeve për korrupsion nga ana e qytetarëve deri te KSHPK. Madje dhjetë herë më pak denoncime për korrupsion kanë arritur në adresë të KSHPK nga ana e qytetarëve në vitin 2015, në krahasim me vitin 2007. Gjegjësisht, vetëm 127 denoncime në vitin 2015, përballë 1.114 tetë vjet më parë. Kjo mund të shpjegohet si ulje e besimit të publikut te KSHPK dhe mosnjohje e tyre nga ana e qytetarëve si një institucion i cili do t'i hulumtojë rastet ku ata dyshojnë për korrupsion.

Bashkëpunimi me organizatat qytetare është i pamjaftueshëm, ndërsa ekspertiza e tyre nuk është shfrytëzuar. Për 72% organizatat nënshkruese të Memorandumit për përkrahje të ndërsjellë për pengimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, bashkëpunimi me KSHPK ka munguar fare ose ka qenë i pamjaftueshëm. Iniciativat për bashkëpunim më shpesh kanë ardhur nga organizatat qytetare, sesa nga KSHPK. Edhe pse në planet e veta vjetore KSHPK planifikon mbajtjen e takimeve tremujore me organizatat qytetare, ata nuk realizohen në bazë të rregullt.

5. TRANSPARENCA

Transparenca nënkupton të qenit në dispozicion dhe qasje të informatave lidhur me punën e KSHPK për publikun. Për nevojën e ndjekjes së transparencës, INDIKATORËT janë ndarë në dy grupe: INDIKATORË të transparencës de jure dhe INDIKATORË të transparencës de fakto.

Transparenca de jure definohet si një obligim i caktuar me ligj i KSHPK për të publikuar materiale të caktuara në ueb-faqen e tij apo në mënyrë tjetër t'ia vë në dispozicion publikut.

Transparenca de fakto definohet si një praktikë e publikimit të materialeve lidhur me aktivitetet të cilat i zbaton KSHPK, por për të cilat KSHPK nuk ka obligim eksplisit ligjor.

Transparenca de fakto është një koncept më i gjerë se transparenca de jure dhe i përfshin të gjitha informatat të cilat janë të disponueshme për qytetarët de jure.

Në këtë raport vlerësimi i transparencës është bërë në bazë të informatave të disponueshme në ueb-faqen e KSHPK (www.dksk.org.mk). Nga 1 shkurti 2017, KSHPK e lëshoi në përdorim ueb-faqen e re (www.dksk.mk). Faqja www.dksk.org.mk nuk do të azhurnohet më, por do të mund të përdoret si arkiv.

PUBLIKIMI I LIGJEVE NËN KOMPETENCA TË KSHPK

Në ueb-faqen e KSHPK janë publikuar:

- Ligji për pengimin e korrupsionit;
- Ligji për pengimin e konfliktit të interesave;
- Ligji për lobim;
- Ligji për mbrojtjen e lajmëtarëve.

Për të gjitha këto ligje janë publikuar versionet e tekstit bazë të ligjit dhe një pjesë të ndryshimeve.

Teksti i pastruar është në dispozicion vetëm në Ligjin për pengimin e konfliktit të interesit nga viti 2009, por kishte ndryshime edhe në vitet 2012 dhe 2015.

5.1. TRANSPARENCA DE JURE

5.1.1. KRIJIMI I POLITIKAVE KUNDËR KORRUPSIONIT

Sipas Ligjit për pengimi e korrupsionit, neni 49 paragrafi 1 alineja 10, KSHPK ka për obligim të dalë me raport vjetor për punën e vet deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë dhe ia dorëzon presidentit të shtetit, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe mjeteve të informimit publik.

TRANSPARENCA DE JURE NË KRIJIMIN E POLITIKAVE

INDIKATOR

IT-1

RAPORT VJETOR I
PUBLIKUAR PËR PUNËN
E KSHPK DHE PËR MASAT
DHE AKTIVITETET E
NDËRMARRA

GJENDJA E DERITANISHME

Të gjitha raportet vjetore janë publikuar në ueb-faqe, nga themelimi deri në vitin 2015.

5.1.2. MBIKËQYRJE DHE KONTROLL

Neni 35 alineja 2 – të dhënat nga fletët anketuese dhe nga fletëparaqitjet për ndryshime të gjendjes së pronësisë, përveç të dhënave të mbrojtura me ligj për personat nga neni 33 alineja 1 në këtë ligj, publikohen në ueb-faqe të Komisionit Shtetëror.

TRANSPARENCA DE JURE NË MBIKËQYRJE DHE KONTROLL

INDIKATOR	GJENDJA E DERITANISHME
IT-2 QASJE DERI TE REGJISTRI PËR PERSONA TË ZGJEDHUR DHE TË EMËRUAR	<p>Në ueb-faqen e vjetër www.dksks.org.mk nuk ekziston një link i drejtpërdrejtë deri te baza e të dhënave, e cila i përmban informatat për personat e zgjedhur dhe të emëruar. Link deri te baza mundëson ueb-faqja e re www.dksk.mk.</p> <p>Qasja deri te të dhënat është e kufizuar sa i përket kërkimit dhe qartësisë së regjistrit. Kërkimi sipas fjalës në fushën e shënuar me “Kërko formularë” është i mundësuar vetëm për emër dhe mbiemër. Kërkimi me përdorimin e një pjese të emrit të institucionit nuk është i mundësuar me opsionin “Kërko formularë”. Për shembull, nëse shkruani fjalën “Komuna”, në pjesën për kërkim “Kërko formularë”, nuk jep asnjë rezultat. Nëpërmjet opsionit “Zgjidh institucion”, mund të arrihet deri te të dhëna për komuna në rast se zgjidhe komunat një nga një, e cila është vendosur në Regjistër. Vërehet se ka mangësi gjatë plotësimit të Regjistrit, sepse në opsionin “Zgjidh institucion” ka edhe shkrim “Kryetar komune”</p> <p>Ekzistimi “historia e ndryshimeve”, gjegjësisht të dhëna historike për ndryshimet e informacioneve për çdo shkrim, mundëson një analizë të ndryshimeve të cilat kanë ndodhur dhe njëkohësisht mundëson vlerësim të vërtetësisë dhe aktualitetit të të dhënave për një shkrim të caktuar. Regjistri i personave të zgjedhur dhe të emëruar nuk ka “histori të ndryshimeve”, i cili mundëson një kontroll të fillimit dhe fundit të kryerjes së funksionit të çdo personi të zgjedhur dhe të emëruar.</p> <p>Nuk ka mundësi të ruhet e tërë baza e të dhënave, me qëllim që të bëhet një analizë/përpunim i të dhënave. Regjistri nuk është në dispozicion në formatin e të dhënave të hapura.</p>

INDIKATOR

GJENDJA E DERITANISHME

IT-3

FLETË ANKETUESE
DHE FLETËPARAQITJE
TË PUBLIKUARA PËR
NDRYSHIME NË GJENDJEN
PRONËSORE NË UEB-
FAQEN E KSHPK

Në ueb-faqen ekziston një link deri te baza e të dhënave, e cila i përmban të gjitha të dhënat e fletëve anketuese të personave të cilët kanë obligim ligjor të dorëzojnë fletëparaqitje për gjendjen pronësore. Të dhënat janë të disponueshme vetëm përderisa zgjatë funksioni publik. Pasi personi nuk e kryen më funksionin publik, të dhënat nga fleta anketuese e tij/saj nuk janë më publike në ueb-faqe.

Ndryshimet në gjendjen pronësore evidentohen në ueb-faqe.

Në ueb-faqe gjenden vetëm të dhëna për gjendjen e fundit të pronës të personave të zgjedhur dhe të emëruar. Ueb-faqja nuk ka “histori të ndryshimeve të ndodhura”, sepse nuk shihet se kur ka ndodhur ndryshimi, me ç’gjë pamundësohet krahasimi i të dhënave për ndjekjen e ndryshimeve.

Nuk ka mundësi të ruhet e tërë baza e të dhënave, me qëllim që të bëhet një analizë/përpunim kompjuterik i të dhënave. Të dhënat për gjendjen pronësore të personave të zgjedhur dhe të emëruar nuk gjenden në formatin e të dhënave të hapura.

Sipas KSHPK, softueri i ri i ka këto funksionalitete dhe do të jenë në dispozicion pas miratimit të ndryshimeve përkatëse ligjore në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

IT-4

PUBLIKIM I NJË RAPORTI
TË POSAÇËM PËR
KEQPËRDORIMET E
MUNDSHME TË MJETEVE
BUXHETORE PËR
FUSHAT ZGJEDHORE
APO PËR FINANCIM TË
AKTIVITETIT ZGJEDHOR
DHE AKTIVITETEVE TË
TJERA POLITIKE

KSHPK deri më tani nuk ka hartuar një raport të tillë, sepse ka konstatuar se në ciklet e deritanishme nuk ka pasur nevojë për këtë, gjegjësisht nuk janë konstatuar keqpërdorime të mjeteve buxhetore.

INDIKATOR

GJENDJA E DERITANISHME

IT-5

PUBLIKIMI I RAPORTIT NË MJETET E INFORMIMIT PUBLIK PËR KONTROLL TË KRYER NË KONTRATA, FURNIZIME PUBLIKE DHE MARRËVESHJE TË TJERA LIDHUR ME PROFITIN E REALIZUAR, TË LIDHURA, GJEGJËSISHT TË REALIZUARA PAS PËRFUNDIMIT TË ZGJEDHJEVE DHE PRIVILEGJE APO DISKRIMINIM TË KONSTATUAR SA U PËRKET KONTRATAVE, FURNIZIMEVE PUBLIKE DHE MARRËVESHJEVE TË TJERA

KSHPK deri më tani nuk kanë publikuar apo hartuar një raport të tillë.

IT-6

PUBLIKIMI I INFORMATAVE PËR RASTET E KONFLIKTIT TË INTERESIT SIPAS TË CILAVE VEPRON KSHPK DHE MASAT DHE AKTIVITETET TË CILAT I KA NDËRMARRË

KSHPK rregullisht publikon informata në ueb-faqen e vet. Në periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2015 janë publikuar në tërësi 43 informata për masa dhe aktivitete të ndërmarra për konflikt interesash. Me këto informata janë përfshirë gjithsej 81 persona, nga të cilët në nivel të lartë 3, në nivel të mesëm 12 dhe në nivel të ulët 66 persona.

IT-7

PUBLIKIMI I PROJEKT-AKTIT PËR DENONCIM TË MBROJTUR TË BRENDSHME NË INSTITUCIONET E SEKTORIT PUBLIK

Në ueb-faqen është publikuar Rregullorja për denoncim të brendshme të mbrojtur në institucionet e sektorit publik („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 46/16).

INDIKATOR**GJENDJA E DERITANISHME****IT-8**

QASJE DERI TE
RAPORTER VJETORE
PËR DENONCIME NGA
LAJMËTARËT

Aplikimi i ligjit ka filluar në mars 2016 dhe raporti i parë vjetor për denoncime të pranuar nga ana e lajmëtarëve duhet të hartohet gjatë vitit 2017.

5.1.3. EDUKIMI DHE INFORMIMI

TRANSPARENCA DE JURE NË EDUKIM DHE INFORMIM

INDIKATOR**GJENDJA E DERITANISHME****IT-9**

INFORMATA PUBLIKE PËR
AKTIVITETET E KSHPK

Në raportet vjetore të KSHPK në pjesën “Raporte me publikun” prezantohen aktivitete të lidhura me ndarjen e informatave me mediet dhe me qytetarët, me qëllim që të kontribuohet në informimin objektiv të qytetarëve. Gjatë viteve vërehen gjithnjë e më pak informata në dispozicion në këtë pjesë të raportit vjetor. Në raportin për vitin 2015 nuk ka të dhëna të kuantifikuara, edhe pse sipas të dhënave në dispozicion, më së shumti informacione (55) në ueb-faqen KSHPK ka publikuar pikërisht në vitin 2015.

Nga viti 2007, kur u krijua ueb-faqja, janë publikuar gjithsej 351 informata në pjesën për lajmërimi, aktivitete, iniciativa të ngritura etj.

5.2. TRANSPARENCA DE FAKTO

Në këtë raport është dhënë përshkrimi i gjendjes për transparencën de fakto, por INDIKATORËT nuk janë të vlerësuar (të ngjyrosur), duke pasur parasysh se për ta nuk ekziston obligim eksplisit ligjor.

5.2.1. KRIJIMI I POLITIKAVE KUNDËR KORRUPSIONIT

TRANSPARENCA DE FAKTO NË KRIJIMIN E POLITIKAVE KUNDËR KORRUPSIONIT

INDIKATOR	GJENDJA E DERITANISHME
IT-10 PUBLIKIMI I PROGRAMEVE DHE PLANEVE TË PUBLIKUARA PËR PUNËN E KSHPK PËR VITIN AKTUAL	<p>Janë publikuar programet vjetore për punën për vitin 2007, 2010, 2011 dhe nga viti 2013 deri në vitin 2017.7</p> <p>Nuk janë publikuar programet vjetore para vitit 2007 dhe për vitin 2012.</p>
IT-11 INFORMATA TË DISPONUESHME PËR MENDIMET E KSHPK PËR PROPOZIME TË LIGJEVE TË RËNDËSISHME PËR PENGIMIN E KORRUPSIONIT	<p>Mendimet të cilat KSHPK i ka paraqitur si propozime të ligjeve, nuk publikohen rregullisht në ueb-faqen.</p> <p>Një shembull i mirë për një informatë të publikuar nga ana e KSHPK është lajmi për ndryshime të iniciuara të Ligjit për konflikt interesash, i publikuar më 14.08.2009 në ueb-faqen e KSHPK.</p>
IT-12 TRANSPARENÇË NË PROCESIN E KONTROLLIT KUNDËR KORRUPSIONIT TË LEGJISLATIVËS (KKL)	<p>Metodologjia për KKL është publikuar në ueb-faqen e KSHPK.</p> <p>Në ueb-faqe nuk ka informata për planin vjetor të KKL.</p>

5.2.2. MBIKËQYRJE DHE KONTROLL

TRANSPARENCA DE FAKTO NË MBIKËQYRJEN DHE KONTROLLIN

INDIKATOR	GJENDJA E DERITANISHME
IT-13 QASJA DERI TE FLETËT ANKETUESE DHE FLETËPARAQITJET PËR NDRYSHIME NË GJENDJEN PRONËSORE, TË PUBLIKUARA NGA ANA E KSHPK	<p>Kërkimi në ueb-faqe është i mundur sipas emrit, mbiemrit, funksionit dhe institucioneve.</p> <p>Ueb-faqja nuk jep mundësi për t'u ruajtura e tërë baza e të dhënave apo pjesë të saj, për të mundur të bëhet përpunim kompjuterik i të dhënave.</p> <p>Të dhënat historike për fletët anketuese dhe për fletëparaqitjet në gjendjen pronësore janë në dispozicion deri në momentin e tërheqjes nga funksioni. Për publikun janë në dispozicion vetëm të dhënat për funksionarët aktual, gjegjësisht për ata që kanë dorëzuar fletë anketuese vetëm për zgjedhje, por jo edhe për përfundimin e funksionit. Pas dorëzimit të fletës anketuese për përfundimin e funksionit, të dhënat për atë person automatikisht nuk janë në dispozicion për publikun, por nuk fshihen nga baza e të dhënave.</p> <p>Në ueb-faqe nuk ruhet "historia e ndryshimeve" për çdo fletë anketuese, gjegjësisht për çdo person, me të cilën gjë nuk lejohet ndjekja e ndryshimeve për çdo shënim në veçanti.</p> <p>Informatat nuk janë në dispozicion në ueb-faqe sepse KSHPK nuk mban një statistikë të tillë.</p>
IT-14 INFORMATAT TË DISPONUESHME PËR DENONCIME TË PARAQITURA PËR EKZISTIMIN E KORRUPSIONIT NGA ANA E QYTETARËVE APO PERSONAVE JURIDIK TË PAKËNAQUR NGA VENDIMI I SJELLË NË BAZË TË AUTORIZIMIT DISKRECIONAL DHE TË CILËT KONSIDEROJNË SE KY VENDIM ËSHTË SJELLË PËR SHKAK TË KORRUPTIMIT	<p>Informatat nuk janë në dispozicion sepse KSHPK nuk mban një statistikë të tillë.</p>

IT-15

DISPONUESHMËRIA E INFORMATAVE PËR KONTROLL SE A KA NDODHUR QË NJË PERSON ZYRTAR NË AFAT PREJ TRE VJET PAS PËRFUNDIMIT TË KRYERJES SË AUTORIZIMEVE APO OBLIGIMEVE PUBLIKE, GJEGJËSISHT PËRFUNDIMIT TË PUNËSIMIT, ËSHTË PUNËSUAR NË NDONJË SHOQATË TREGTARE NË TË CILËN KA KRYER KONTROLL APO KA VENDOSUR ÇFARËDO RELACIONI ME MARRËVESHJE GJATË KRYERJES SË AUTORIZIMEVE DHE OBLIGIMEVE PUBLIKE

Nuk ka informata të disponueshme në ueb-faqe.

INDIKATOR

GJENDJA E DERITANISHME

IT-16

DISPONUESHMËRIA E INFORMATAVE PËR EKZISTIMIN APO MOSEKZISTIMIN E DENONCIMEVE PËR FITIMIN E AKSIONEVE NË ÇFARËDO BAZE, ËSHTË BËRË PJESE E PERSONIT JURIDIK KU KA PUNUAR, GJEGJËSISHT KA BËRË KONROLL PERSONI ZYRTAR PAS PËRFUNDIMIT TË KRYERJES SË AUTORIZIMEVE APO OBLIGIMEVE PUBLIKE

KSHPK nuk harton një raport të tillë.

IT-17

DISPONUESHMËRI TË
INFORMATAVE PËR
DENONCIME NGA
ANA E LAJMËTARËVE
PËR MBROJTJE TË
PASIGURUAR NË
INSTITUCIONIN
PËRKATËS

Nuk ka informacione të publikuara për ekzistimin apo mos ekzistimin e denoncimeve nga ana e lajmëtarëve për mos sigurim të mbrojtjes në institucionin përkatës.

IT-18

INFORMACIONE NË
DISPOZICION PËR
AKTIVITETE DHE
MASA TË NDËRMARRA
NGA ANA E KSHPK
SI PËRGJIGJE TË
DENONCIMEVE
TË MARRA NGA
LAJMËTARËT PËR
MBROJTJE TË
PASIGURUAR PËR TA

Jo, për shkak se nuk ka denoncime të këtij lloji.

5.2.3. BASHKËPUNIMI

TRANSPARENCA DE FAKTO E BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONET E TJERA, ME SHOQATAT QYTETARE DHE ME SEKTORIN PRIVAT

INDICATOR	GJENDJA E DERITANISHME
IT-19 DISPONUESHMËRIA E INFORMATAVE NË UEB-FAQEN PËR BASHKËPUNIMIN ME INSTITUCIONET E TJERA SHTETËRORE NË MAQEDONI DHE JASHTË	<p>Në ueb-faqe është publikuar Protokollin për bashkëpunim për preventivë dhe represion ndaj korrupsionit dhe konfliktit të interesave mes KSHPK dhe institucioneve të tjera shtetërore në Maqedoni.</p> <p>Në ueb-faqe është publikuar një raport për zbatimin e Protokollit për bashkëpunim me institucionet për periudhën nga janari deri në qershor të vitit 2013.</p> <p>Në ueb-faqen e KSHPK janë publikuar gjithsej 17 informata të cilat kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërkombëtar. Nga ato, pesë lajme përmbajnë informata për takime të realizuara pune, pesë informata për memorandume të nënshkruara për bashkëpunim, katër informata janë për vizita të realizuara studimore dhe nga një informatë për një protokoll të nënshkruar, pjesëmarrje në konferencë dhe trajnim. Në ueb-faqe është publikuar Protokollin për bashkëpunim mes KSHPK dhe Shërbimit për Pengimin e Mashtrimeve në Kataloni. Në ueb-faqe është publikuar edhe lajmi për memorandumit e nënshkruar me Agjencinë për Luftë Kundër Korrupsionit të Republikës së Serbisë. Por, më tej në ueb-faqe nuk ka informata për aktivitetet e ndërmarra nga bashkëpunimi në bazë të memorandumeve të nënshkruara.</p>
IT-20 DISPONUESHMËRIA E INFORMATAVE NË UEB-FAQE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQATAT QYTETARE	<p>Në pjesën për bashkëpunim me shoqatat qytetare në ueb-faqe janë publikuar tetë lajme. Gjashtë prej tyre kanë të bëjnë me bashkëngjitjen e organizatave të reja ndaj memorandumit. Një lajm ka të bëjë me takimin e mbajtur më 22 shtator 2010, në të cilin është biseduar për përcaktimin e drejtimeve për bashkëpunim për realizimin e aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta nga fusha e preventivës nga korrupsioni dhe konflikti i interesave. Një lajm ka të bëjë me Raportin për bashkëpunim me organizatat qytetare, por linku deri te këta dokumente nuk funksionon.</p>

INDIKATOR**GJENDJA E DERITANISHME****IT-21**

DISPONUESHMËRIA
E INFORMACIONEVE
NË UEB-FAQE PËR
BASHKËPUNIM ME
SHOQATAT QYTETARE

Në pjesën për bashkëpunim me sektorin privat, në ueb-faqe është publikuar Memorandumi për Bashkëpunim dhe Raporti për Realizimin e Memorandumit për periudhën janar deri në qershor 2013. Në ueb-faqe nuk ka lajme të publikuar për takime të realizuara dhe aktivitete mes KSHPK dhe përfaqësues të sektorit privat.

5.2.4. EDUKIMI DHE INFORMIMI

TRANSPARENCA DE FAKTO E EDUKIMIT

INDIKATOR**GJENDJA E DERITANISHME****IT-22**

PREZANTIM I RREGULLT
I AKTIVITEVE DHE
REZULTATEVE TË
ARRITURA TË PUBLIKUT

Në bazë të të dhënave në dispozicion në ueb-portalin www.time.mk, në periudhën prej vitit 2006 deri në vitin 2015 janë publikuar gjithsej 1.323 lajme. Pothuajse gjysma e këtyre lajmeve janë publikuar në vitin 2003 (280) dhe në vitin 2015 (240).

IT-23

DISPONUESHMËRIA
E INFORMATAVE NGA
SEANCAT E MBAJTURA TË
KOMISIONIT

Nuk ka praktikë të publikimit të rregullt në ueb-faqe të:

- paralajmërimeve për mbajtje të seancave dhe agjendë të seancës;
- material shoqëruar nga seancat;
- procesverbale nga seancat.

Seancat e Komisionit nuk janë publike, në rast se nuk vendoset ndryshe.

Nga viti 2016 në seancat publike publikohen paralajmërime të rendit të ditës, si dhe informata për seancën e mbajtur.

Sipas Ligjit për pengimin e korrupsionit, neni 51 alineja 4 për shqyrtimin e disa çështjeve, në seancat e Komisionit mund të ftohen ekspertë të shquar. Nuk ka informata të disponueshme se sa shpesh KSHPK e ka praktikuar këtë.

5.3 KONKLUZIONE PËR TRANSPARENCËN

Nga gjithsej nëntë INDIKATORË de jure, të cilët janë definuar për vlerësimin e transparencës së KSHPK, tre realizohen në pajtim me kompetencat e dhëna ligjore, te katër INDIKATORË kompetencat plotësohen, por pamjaftueshëm dhe në mënyrë joadekuate dhe për një INDIKATOR kompetencat e dhëna ligjërisht nuk përmbushen, ndërsa një INDIKATOR do të ndiqet nga viti 2017.

Nga ana tjetër, KSHPK në periudhën e ndjekjes, nuk ka ndërmarrë aktivitete plotësuese për një transparencë të rritur dhe standarde më të larta në informimin e publikut, të cilat ndiqen nëpërmjet INDIKATORËVE de facto të transparencës.

KSHPK rregullisht i publikon planet dhe raportet vjetore të punës së vet. Të gjithë raportet vjetore janë publikuar në ueb-faqen e KSHPK.

Regjistri i personave të zgjedhur dhe të emëruar, si një mjet i ri i KSHPK për ndjekjen e personave aktual dhe të mëparshëm të zgjedhur dhe të emëruar, nuk është funksional në tërësi. Kufizimet sa i përket kërkimit, mungesa e “historisë së të dhënave”, si dhe pamundësia për t’u përpunuar të dhënat, e ulin vlerën e këtij mjeti dhe mund të rezultojnë me dyshime sa i përket qëllimit për transparencë në KSHPK.

Informimi i pamjaftueshëm i publikut për aktivitetet lidhur me krijimin e politikave. Edhe pse nuk është obligim ligjor, KSHPK ndër vite ka lëshuar mundësinë ta informojë publikun për të gjitha mendimet e dhëna nga ana e KSHPK për një propozim-ligj të caktuar. Gjithashtu, deri më 31 dhjetor 2016 vazhdon të mos ketë informata lidhur me kontrollin kundër korrupsionit të legjislaturës. Edhe pse u soll në shtator 2015, Metodologjia për kontroll kundër korrupsionit në legjislaturë nuk u publikua deri më 31 dhjetor 2016. Nuk është publikuar plani për kontrollin kundër korrupsionit në legjislaturë në vitin 2017.

Transparenca dhe aktivitetet lidhur me mbikëqyrjen dhe kontrollin nuk është e mjaftueshme. Nëpërmjet ueb-faqes së KSHPK publiku në mënyrë të rregullt është i informuar për raste lidhur me konfliktin e interesave dhe për masat dhe aktivitetet e ndërmarra. Por, transparencë e pamjaftueshme është vërejtur te aktivitetet lidhur me mbikëqyrjen dhe kontrollin e evidentimit dhe ndjekjes së gjendjes pronësore të funksionarëve publik. Ueb-aplikimet ekzistuese të cilat duhet të mundësojnë transparencë të të ardhurave dhe pronës së personave të zgjedhur dhe të emëruar (Regjistri i personave të zgjedhur dhe të emëruar dhe fletët anketuese) nuk i mundësojnë publikut informata lehtë të kërkueshme dhe të qarta.

Rritet numri i informatave për aktivitetet dhe masat e ndërmarra të cilat publikohen në ueb-faqe. Në vitin 2015 dhe 2016 vërehet ndarje më e shpeshtë e informatave për aktivitetet e KSHPK në ueb-faqe. Në vitin 2016 janë publikuar 55 informata, që, sa i përket sasisë, paraqet numrin më të madh të informatave të publikuara gjatë një viti, nga vendosja e ueb-faqes. Njëkohësisht, nga viti 2016 është vendosur praktika e publikimit të informatave për mbajtjen e seancave publike dhe lëshimin e lajmërimeve me vendime të dala nga seancat e mbajtura.

6. LLOGARIDHËNIA

Me nivelin e lartë të llogaridhënies, KSHPK si i pavarur dhe i mëvetësishëm në zbatimin e kompetencave të veta, sigurohet se punon në interes të publikut dhe pengohet ose relativizohet puna potenciale për interesa personale. Njëri nga mekanizmat për rritjen e llogaridhënies është avancimi i të ashtuquajturës “llogaridhënie horizontale”, si një mënyrë alternative të kontrollit të trupave rregullatore. Për dallim nga “llogaridhënia vertikale”, e cila nënkupton përgjigje hierarkike para një institucioni tjetër, “llogaridhënia horizontale përfshin ndjekje nga ana e palëve të tjera të prekura, të cilat nuk kanë kontroll formal mbi institucionin, si për shembull organizatat qytetare, sektori privat, institucionet e “nivelit” të ngjashëm hierarkik, mediet dhe publiku.⁷

Duke pasur parasysh këtë, INDIKATORËT e llogaridhënies duhet të përgjigjen për nivelin e realizimit të “llogaridhënies vertikale” formale para institucioneve para të cilave përgjigjet KSHPK, si dhe llogaridhënie ndaj të gjitha palëve të tjera të prekura para të cilave KSHPK nuk ka përgjegjësi formale (institucione të tjera, sektori qytetar, qytetarët, mediet, biznes-bashkësia etj.).

6.1. LLOGARIDHËNIA PËRBALLË INSTITUCIONEVE

Llogaridhënia përballë institucioneve ka të bëjë me të gjitha kompetencat për të cilat KSHPK ka përgjegjësi ligjore për të dorëzuar një raport për punën e vet për një aktivitet të caktuar ose përgjegjësi e cila është vënë në praktikë me ndonjë akt joobligues, siç është Protokollin për bashkëpunim me institucionet të cilat kanë kompetenca lidhur me luftën kundër korrupsionit.

INDIKATOR	GJENDJA E DERITANISHME
ILL 1 DORËZIMI I RAPORTIT VJETOR PËR PUNËN E KSHPK	KSHPK dorëzon raport vjetor në Kuvend.

⁷ Tomic S., Taseva S., Popovic I., Jovancic A., Vojinovic Z. (2015). Agency Transparency- and Accountability: Comparative Analysis of Five Regulated Sectors in Serbia and Macedonia. Belgrade, Serbia: Belgrade Institute for Public Policy.

INDIKATOR

GJENDJA E DERITANISHME

ILL 2

DORËZIMI I RAPORTIT
VJETOR PËR DENONCIME
TË PRANUARA NGA
LAJMËTARËT

Zbatimi i Ligjit për lajmëtarët filloi në mars të vitit 2016 dhe ky lloj raporti për herë të parë do të hartohet për vitin 2016.

ILL 3

DORËZIMI I RAPORTIT
TË POSAÇËM NË
KUVENDIN E REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË PËR
KEQPËRDORIMET E
MUNDSHME TË MJETEVE
BUXHETORE, FONDET
PUBLIKE DHE MJETET E
NDËRMARRJEVE PUBLIKE
DHE PERSONAVE TË
TJERË PUBLIK TË CILËT
DISPONOJNË ME KAPITAL
SHTETËROR LIDHUR
ME ZGJEDHJE DHE
AKTIVITETE POLITIKE

KSHPK nuk ka hartuar një raport të posaçëm për keqpërdorimet e mundshme të mjeteve buxhetore, fondeve publike dhe mjeteve të ndërmarrjeve publike dhe personave të tjerë juridik të cilët disponojnë me kapital shtetëror për fushatë zgjedhore apo aktivitete të tjera zgjedhore apo politike. Në rast se hartohet raporti, ai dorëzohet në Kuvend. Sipas KSHPK, deri më tani nuk ka pasur nevojë për një raport të posaçëm të këtij lloji, sepse nuk janë konstatuar keqpërdorime.

ILL 4

DORËZIMI I RAPORTIT
PËR RASTE TË
IDENTIFIKUARA TË
PRIVILEGJEVE APO
DISKRIMINIMIT SA U
PËRKET KONTRATAVE,
FURNIZIMEVE PUBLIKE
DHE MARRËVESHJEVE TË
TJERA PAS ZGJEDHJEVE

Nuk është hartuar një raport i këtillë.

6.2. LLOGARIDHËNIE PARA PUBLIKUT

Llogaridhënia para publikut, organizatave qytetare dhe sektorit privat nënkupton informim të tyre të rregullt për aktivitetet dhe masat e ndërmarra nga ana e KSHPK.

Njëra nga mënyrat për llogaridhënie aktive ndaj publikut është edhe nëpërmjet shfrytëzimit të Ligjit për qasje të lirë deri te informatat e karakterit publike, i cili filloi me zbatim më 1 shtator 2006.

INDIKATOR

GJENDJA E DERITANISHME

ILL 5

LLOJI I INFORMATAVE TË CILAT KSHPK I KA DORËZUAR DERI TE MEDIET ELEKTRONIKE DHE TË SHTYPURA PUBLIKE PËR AKTIVITETET DHE REZULTATET E SAJ

Në bazë të të dhënave në dispozicion në ueb-portalin www.time.mk, në periudhën nga viti 2006 deri në vitin 2015 janë publikuar 1.232 lajme.

KSHPK nuk praktikon informatat dhe arritjet nga raportet e veta vjetore t'i ndajë me publikun nëpërmjet përmbajtjeve të thjeshta dhe të shkurta, me të cilat qytetarët, si obligues tatimor nga të cilët financohet KSHPK, mund të njihen me efektet e veprimeve të tyre.

ILL 6

VEPRIM SIPAS KËRKESËS PËR QASJE DERI TE INFORMATAT TË KARAKTERIT PUBLIK

Në raportet vjetore për vitin 2007 dhe 2009 ka të dhëna detale për përmbajtjen e informatave të kërkuara. Në raportet e tjera vjetore në lidhje me veprimet me kërkesë për qasje deri te informatat e karakterit publike janë kuantitative.

Nga viti 2007 deri në vitin 2015 KSHPK ka pranuar 200 kërkesa për qasje deri te informatat e karakterit publik. Më së shumti (54) janë pranuar në vitin 2015. Në këtë vit janë shënuar edhe më së shumti ankesa të bëra, gjegjësisht kërkuesit e informatave kanë bërë 41 ankesa kundër

kërkesave të KSHPK për t'i plotësuar kërkesat e tyre. Të gjitha këto ankesa janë refuzuar nga ana e organit të shkallës së dytë, si të pabaza.

Nga gjithsej 22 kërkesave të bëra për informata në vitin 2007 dhe 2009, 12 prej tyre kanë të bëjnë me kërkesa për qasje në fletën anketuese, tri kërkesa janë për procesverbale të seancave të KSHPK, dy kërkesa për iniciativa për pengimin e korrupsionit dhe nga një kërkesë për raport vjetor, dyshim për korrupsion te organizata fetare, raste të konfliktit të interesit dhe një numër i parashtrësive dhe kërkesa për dorëzimin e listave me informata të karakterit publik.

Në raportet vjetore nuk ka informata se ç'ka ndërmarrë KSHPK për t'i bërë informatat e kërkuara të disponueshme për publikim në ueb-faqen e KSHPK. Nga analiza e të dhënave për përmbajtjen e kërkesave të disponueshme në raportet e vitit 2007 dhe 2009, mund të konstatohet se një pjesë e informatave të cilat janë kërkuar për qasje deri te informatat me karakter publik, rregullisht publikohen në ueb-faqe.

ILL 7

SHFRYTËZIMI I MEDIJEVE SOCIALE PËR NDARJEN E INFORMATAVE ME PUBLIKUN

KSHPK nuk shfrytëzon asnjë nga mediet sociale për ndarjen e informatave me publikun.

6.3. KONKLUZIONE PËR LLOGARIDHËNIEN

Nga gjithsej shatë INDIKATORËVE të cilët definojnë për vlerësimin e llogaridhënies së KSHPK, njëri realizohet në pajtim me kompetencat e dhëna ligjore, te dy INDIKATORË përmbushen kompetencat, por në mënyrë të pamjaftueshme apo joadekuate dhe për dy INDIKATORË kompetencat e dhëna me ligj nuk përmbushen, ndërsa dy INDIKATORË do të vlerësohen në vitin 2017.

Llogaridhënien formale KSHPK e ka për obligim ndaj Kuvendit dhe realizohet në nivel themelor. KSHPK i përmbush obligimet për dorëzimin e raporteve vjetore deri te Kuvendi. Por, KSHPK edhe pse ka obligim ligjor që më së voni tre muaj nga dita e përfundimit të zgjedhjeve Kuvendit t'i dorëzojë një raport të posaçëm për keqpërdorimet eventuale të mjeteve buxhetore gjatë zgjedhjeve, KSHPK deri më tani nuk e ka bërë këtë për asnjërin nga tetë proceset e realizuara zgjedhore në periudhën prej vitit 2006 deri në vitin 2015.⁸ Gjithashtu, KSHPK për asnjë nga proceset e realizuara zgjedhore nuk ka dorëzuar raport në Kuvend për kontrollin e kryer në kontratat, furnizimet publike dhe marrëveshjet e tjera lidhur me profitin e realizuar, të bëra pas përfundimit të zgjedhjeve.

⁸ Zgjedhje presidenciale në vitin 2009 dhe 2014, zgjedhje parlamentare në vitin 2006, 2008, 2011 dhe 2014 dhe zgjedhje lokale në vitin 2009 dhe 2013

SHTOJCA 1.

NUMRI I FLETËVE ANKETUESE TË DORËZUARA NGA KSHPK

	2015	2014	2013	2012	2011	2010	2009	2008	2007	2006
Fletë anketuese sipas zgjedhjes/emërimit në funksion	552	441	1.438	195	346	541	694	/	294	303
Fletë anketuese pas përfundimit të funksionit	145	238	429	60	132	57	100	204	71	182
Ndryshimi i funksionit	17	45	10	31	93	47	24	40	31	42
Fletë anketuese/raportim për zgjedhje të dytë	14	91	76	9	94	11	35	10	5	31
Raportim për ndryshim të gjendjes pronësore	404	384	217	328	235	146	146	197	153	86
TOTAL	1.132	1.199	2.170	623	900	802	999	451	554	644

SHTOJCA 2.

RASTE TË PUBLIKUARA PËR KONFLIKT INTERESASH NË UEB-FAQEN E KSHPK

RASTE TË PUBLIKUARA PËR KONFLIKT INTERESASH NË UEB-FAQEN

VITI	2007	2008	2009	2010	2011	2011	2012	2013	2014	2015	2015	2016	TOTAL
PERIUDHA	01.01.07	01.01.08	01.01.09	01.01.10	01.01.11	06.04.11	01.01.12	01.01.13	01.01.14	01.01.15	14.4.15	01.01.16	
NIVELI	31.12.07	31.12.08	31.12.09	31.12.10	5.4.11	31.12.11	31.12.12	31.12.13	31.12.14	13.4.15	31.12.15	31.12.16	
I LARTË	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1	1	1	4
I MESËM	0	0	0	6	0	0	0	2	2	0	1	0	12
I ULËT	1	0	0	5	0	0	0	12	38	1	9	15	81
TOTAL	1	0	0	12	0	0	0	14	40	2	11	16	97

BIBLIOGRAFIA

LIGJET

Ligji për pengimin e korrupsionit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, 97/2015, 148/2015)

Ligji për konflikt interesash (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/2010, 97/2015, 148/2015)

Ligji për mbrojtjen e lajmëtarëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 196/2015)

Udhëzues për bashkëpunim të organeve të drejtorisë shtetërore, ndërmarrjeve publike, institucioneve publike dhe personave të tjerë juridik të cilët disponojnë me kapital shtetëror me Komisionin Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 81/2004 и 135/2006)

DOKUMENTE DHE PROGRAME STRATEGJIKE

Komisioni Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit (2016). Raport vjetor për punën e KSHPK për vitin 2015 I disponueshëm në:

www.dksk.org.mk/images/Drzavni_Programi/izvestaj_zarabotataza_2015_-_dksk.pdf

Komisioni Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit (2015). Raport vjetor për punën e KSHPK për vitin 2014. I disponueshëm në:

www.dksk.org.mk/images/Drzavni_Programi/ГОДИШЕН_ИЗВЕШТАЈ-2014-ДКСК.pdf

Komisioni Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit (2014). Raport vjetor për punën e KSHPK për vitin 2013. I disponueshëm në:

www.dksk.org.mk/images//godisen_izvestajdsk_2013.pdf

Komisioni Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit (2013). Raport vjetor për punën e KSHPK për vitin 2012. I disponueshëm në:

www.dksk.org.mk/images//godisenizvestaj2012.pdf

Komisioni Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit (2012). Raport vjetor për punën e KSHPK për vitin 2011. I disponueshëm në:

www.dksk.org.mk/images/stories/pdf/god_izvestaj_2011.pdf

Komisioni Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit (2011). Raport vjetor për punën e KSHPK për vitin 2010. I disponueshëm në:

www.dksk.org.mk/images/stories/pdf/godisni_izvestaj/god.izvestaj_2010.pdf

Komisioni Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit (2010). Raport vjetor për punën e KSHPK për vitin 2009. I disponueshëm në:

www.dksk.org.mk/images/stories/pdf/dokument/godisen_izvestaj_2009.pdf

Komisioni Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit (2009). Raport vjetor për punën e KSHPK për vitin 2008. I disponueshëm në:

www.dksk.org.mk/images/stories/pdf/dksk_godisen_izvestaj_2008.pdf

Komisioni Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit (2008). Raport vjetor për punën e KSHPK për vitin 2007. I disponueshëm në:

www.dksk.org.mk/images/stories/pdf/godisni_izvestaj/god.izvestaj_2007.pdf

Komisioni Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit (2007). Raport vjetor për punën e KSHPK për vitin 2006. I disponueshëm në:

http://www.dksk.org.mk/images/stories/pdf/godisni%20izvestai/god.izvestaj_2006.pdf

Komisioni Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit (2015). Metodologjia për kontroll kundër korrupsionit të legjislaturës. E disponueshme në:

www.dksk.mk/fileadmin/PDF/Metodologjia_za_APL.pdf

Komisioni Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit (2015). Raport për realizimin e Protokollit për bashkëpunim për preventivë dhe represion të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, për periudhën janar-qershor 2013. I disponueshëm në:

www.dksk.org.mk/images/stories/pdf/sorabotka/izvestaj%20protokolot%20za%20sorabotka%202013.pdf

ANALIZA

Mangova I. (2013). A sjellë rezultate modeli kundër korrupsionit në Maqedoni?

Faktorë kyç të cilët i e bëjnë një model të suksesshëm. Shkup: Instituti për Demokraci Societas Civilis – Shkup. E disponueshme në:

www.academia.edu/3081031/Is_the_Anti-Corruption_Model_Delivering_Results_in_Macedonia

Nuredinska E., Sazdevski M., Gjuzellov B. (2016). Raport për vlerësimin e korrupsionit në Maqedoni. Shkup: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar. I disponueshëm në:

mcms.mk/images/docs/2014/izvestaj-za-procenka-na-korupcijata-vo-makedonija-2014.pdf

TomicS., TasevaS., Popovici., JovancicA., Vojinovic Z. (2015). Agency Transparency and Accountability: Comparative Analysis of Five Regulated Sectors in Serbia and Macedonia. Belgrade, Serbia: Belgrade Institute for Public Policy. E disponueshme në:

www.rpp-westernbalkans.net/en/research/Completed-Projects/2015/-Are-regulatory-agencies-in-Serbia-and-Macedonia-transparent-and-accountable-.html

BURIME TË TJERA

OpendataMacedonia,

<https://data-mkopen.rhcloud.com/>

